



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

# UDHËZUES PËR PËRCAKTIMIN E FUSHAVE ME RISK 2025



Departamenti i Auditimit  
të Performancës

[www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Tetor, 2025

## **PËRMBAJTJA**

I. HYRJE.....	3
I. 1 Qëllimi i Udhëzuesit për përcaktimin e fushave me risk.....	5
I. 2 Identifikimi i fushave/programeve me risk të lartë në sektorin publik.....	6
I. 3 Faktorët që ndikojnë në përcaktimin e risqeve.....	7
I. 4 Fushat me risk të identifikuara .....	8
II. ANALIZA E FUSHAVE ME RISK .....	10
II. 1 ARSIMI.....	10
II. 2 SHËNDETËSIA DHE MBROJTJA SOCIALE.....	17
II. 3 MBLEDHJA E TË ARDHURAVE .....	24
II. 4. INFRASTRUKTURA .....	29
II. 5 MJEDISI.....	35
II. 6 ENERGJIA.....	43
II. 7 TREGU I PUNËS.....	45
II. 8 ADMINISTRATA PUBLIKE.....	49

## I. HYRJE

Auditimi i performancës i kryer nga KLSH është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm nëse entet publike, sistemet, operacionet, programet ose aktivitetet funksionojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe/ose efektivitetit (3 E - të). Standardet e përgjithshme të auditimit të INTOSAI-t<sup>1</sup> përcaktojnë që secili SAI duhet të hartojë politika dhe procedura për përgatitjen e manualeve dhe udhëzuesve në mbështetje të auditimeve të përputhshmërisë, financiare dhe të performancës. Në këtë mënyrë i ofrohet SAI – ve dhe stafit të tyre auditues një bazë e mirëfilltë udhëheqjeje metodologjike e mbështetur në standardet e INTOSAI – t. Auditimi i performancës ka për qëllim të ofrojë informacione, analiza ose njohuri të reja dhe sipas rastit, rekomandime për përmirësim në sektorin publik. Auditimi i performancës shpesh herë përfshin një analizë të kushteve që janë të nevojshme për t’u siguruar nëse parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit janë respektuar ose jo.<sup>2</sup>

Referuar ISSAI-t 3000, Standardit të Auditimit të Performancës:

- Audituesi duhet t’i përzgjedhë temat e auditimit të planifikimit vjetor përmes procesit të planifikimit strategjik të SAI-t, duke analizuar temat e mundshme dhe kryer kërkime për të identifikuar risqet dhe problemet objekt auditimi;
- Audituesi duhet të përzgjedhë tema auditimi që janë të rëndësishme dhe të auditueshme, e në përputhje me mandatin e SAI-t;
- Audituesi duhet ta kryejë procesin e përzgjedhjes së temave të auditimit me synim maksimizimin e ndikimit të pritshëm të auditimit, duke marrë parasysh kapacitetet e auditimit.

Procesi i planifikimit të SAI-t është hapi i parë në përzgjedhjen e temës, sepse ai përfshin analizën e fushave të mundshme për auditim dhe përcakton bazën për shpërndarjen eficiente të burimeve të auditimit. Gjatë procesit të planifikimit të auditimeve, teknika të tilla si analiza e riskut ose vlerësimi i problemeve mund të ndihmojnë në strukturimin e procesit. Ato duhet të plotësohen me gjykim profesional për të pasqyruar mandatin e SAI-t dhe për të siguruar që janë përzgjedhur tema auditimi të rëndësishme e me impakt social dhe të auditueshme.

Auditueshmëria është një kërkesë e rëndësishme në procesin e planifikimit. Ajo përcakton nëse një temë është e përshtatshme për auditim. Audituesit duhet të zgjedhë një qasje auditimi të orientuar drejt rezultatit të pritshëm, problemit ose sistemit që trajtohet, ose mund të kemi kombinimin e tyre. Duhet të synohet analizë risku në aktivitetin ndërsektorial ose në hierarkinë funksionale, kjo duke u mbështetur në analizën e riskut të funksionimit të kontrollit të brendshëm (sistemi i ngritur dhe funksionaliteti) në sistemin vertikal nga lart poshtë dhe anasjelltas si dhe horizontal (departamente apo sektorë, etj.) Këtu duhet pasur parasysh funksionimi i subjektit, rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve si dhe arritjet apo mangësitë e departamentit, sektorit apo njësisë publike funksionale, mënyra e menaxhimit, (mund të kryhen testime dhe të përdoren indikatorë vlerësimi e analizë risku në thellësi të aktivitetit, për të evidentuar mangësitë e gjetura dhe bazën e rekomandimeve për përmirësimin e qeverisjes e menaxhimit dhe arritjen e qëllimit të auditimit të

---

<sup>1</sup> Standardet e Auditimit INTOSAI, të aprovuara në mbledhjen e 35 të Bordit Udhëheqës të mbajtur në tetor 1991.

<sup>2</sup> GUID 3910 “Koncepte Kryesore për Auditimin e Performancës”, INTOSAI, 2019. <https://www.issai.org/wpcontent/uploads/2019/08/GUID-3910-Central-Concepts-for-Performance-Auditing.pdf>

performancës. Audituesi mund t'i duhet të shqyrtojë, për shembull, nëse ekzistojnë qasje, metodologji e kritere auditimi përkatëse dhe nëse informacioni i kërkuar ka të ngjarë të jetë i disponueshëm dhe mund të merret në mënyrë eficiente. Nëse audituesi përcakton se informacioni i besueshëm nuk është i disponueshëm, atëherë kjo mund të jetë vetë një arsye për zgjedhjen e kësaj fushe për auditim.

Në mbledhjen e informacionit për tema auditimi, audituesi duhet të analizojë masat e marra dhe instrumentet e përdorura nga qeveria për zbatimin e vendimeve të Parlamentit nëpërmjet ligjeve, rezolutave dhe mjete të tjera detyruese për qeverinë me ndikim publik e social, në përmbushje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 me karakter kombëtar, rajonal e global. Meqenëse SAI mund të ketë kapacitete të kufizuara auditimi për sa i përket burimeve njerëzore dhe aftësive profesionale, procesi i përzgjedhjes së temës së auditimit duhet të marrë parasysh ndikimin e mundshëm të temës së auditimit në ofrimin e përfitimeve të rëndësishme për financat dhe administrimin publik, subjektin e audituar ose publikun e gjerë me burimet në dispozicion. Aspekte të tjera që duhen marrë parasysh në përzgjedhjen e temave janë rezultatet dhe rekomandimet e auditimeve ose ekzaminimeve të mëparshme. Kështu, referuar ISSAI-t 3000 dhe Manualit të Auditimit të Performancës, audituesit, gjatë përzgjedhjes së temave për auditim, duhet të konsiderojnë disa kritere potenciale që mund të përdoren në vlerësimin e propozimeve për auditim, të cilat përfshijnë (por nuk kufizohen me):

1. Mandatin e KLSH-së;
2. Performancën e institucioneve publike;
3. Fushat problematike apo fushat më të rëndësishme (ose fushat me risk);
4. Ndjeshmërinë publike ndaj temës së propozuar;
5. Rëndësinë e temës së propozuar kundrejt financave publike, kriteret e alokimit të buxheteve;
6. Materialitetin;
7. Riskun dhe probleme të performancës;
8. Auditueshmërinë e subjektit apo çështjes së propozuar;

Gjithashtu, Indikatori i Vetëvlerësimit nr. 8 (SAI – 8)<sup>3</sup>, sipas Kuadrit të Vetëvlerësimit të miratuar nga INTOSAI, parashikon që: “Gjatë 5 viteve, Institucioni Suprem i Auditimit të ketë evaduar raporte që mbulojnë të paktën 6 nga 10 fushat në vijim (sipas ISSAI 12:5, dhe ISSAI 300:36), konkretisht:

1. Shëndetësia;
2. Mjedisi;
3. Mbledhja e të Ardhurave;
4. Infrastruktura;
5. Financat dhe Administrata publike;
6. Siguria sociale dhe tregu i punës;
7. Arsimi;
8. Mbrojtja;
9. Zhvillimi ekonomik kombëtar;
10. Reforma të rëndësishme në sektorin publik.

---

<sup>3</sup> Self-Assessment Indicator - SAI

Gjatë viteve të fundit, KLSH ka vijuar punën, duke synuar integrimin e praktikave të tij me zhvillimet më të reja në fushën e standardeve të auditimit, duke zbatuar instrumente specifike iCATS për performancën e institucionit, për krijimin dhe funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe për vlerësimin dhe përmirësimin e auditimeve të performancës me mbështetjen e partnerëve kryesorë të tij, si Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI – t (IDI) dhe veçanërisht Institucioneve Supreme të Auditimit të Norvegjisë e Suedisë.

Gjithashtu, KLSH, duke realizuar disa auditime performance në bashkëpunim me partnerë të tjerë rajonalë, si UN Woman dhe SAI të rajonit të Ballkanit Perëndimor ka rritur përdorimin e qasjeve të bazuara në analizën e riskut ndërsektorial dhe përputhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) – *Sustainable Development Goals* (SDG).

### **I. 1 Qëllimi i Udhëzuesit për përcaktimin e fushave me risk**

Ky dokument vjen si përditësim i të njëjtit dokument të miratuar në Janar 2023 nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Qëllimi i tij është përditësimi i udhëzuesit të mëparshëm me ndryshimet kryesore të ndodhura në disa prej sektorëve kryesorë që trajtohen në kapitujt e mëposhtëm. Ky udhëzues synon të ndihmojë audituesit në përcaktimin e fushave me risk në procesin e planifikimit strategjik dhe vjetor të auditimeve të performancës, duke siguruar një proces më të standardizuar dhe të lidhur me objektivat e institucionit, si dhe zhvillimet ekonomike, sociale, teknologjike etj. Objektivat kryesorë janë:

- Të ndihmojë audituesit në zhvillimin e metodave dhe mënyrën e kryerjes së vlerësimit dhe përcaktimit të riskut në planifikimin e auditimeve të performancës.
- Rritja e kapaciteteve profesionale të audituesve përmes trajnimeve sistematike në menaxhimin e riskut dhe auditimet me bazë SDG.
- Integrimi i Rezolutave të Kuvendit 2023 dhe 2024, të cilat theksojnë forcimin e rolit të KLSH-së në monitorimin e financave publike, digjitalizimin dhe transparencën.
- Evidentimi i fushave të reja me ndjeshmëri publike, si: digjitalizimi i shërbimeve, menaxhimi i emergjencave civile, siguria kibernetike, shëndeti mendor dhe mbrojtja e burimeve natyrore.

Ky udhëzues mbështet edhe Planin Strategjik të KLSH 2023 – 2027, duke e lidhur planifikimin e auditimeve me reformat kryesore në qeverisje dhe objektivat kombëtare për integrimin në BE dhe përmbushjen e SDG - ve.

Identifikimi i fushave me risk të lartë përbën një nga shtyllat themelore të punës së KLSH-së dhe realizohet në përputhje me kërkesat e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë. Kuvendi ka kërkuar që Departamenti i Auditimit të Performancës, në bashkëpunim të ngushtë me departamentet e tjera të KLSH-së, të kryejë analiza të thelluara për të evidentuar fushat me ndjeshmëri të lartë publike dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe menaxhimin e shëndoshë të financave publike. Ky proces është menduar të shërbejë si bazë për planifikimin dhe realizimin e auditimeve që fokusohen tek shërbimet me impakt konkret për qytetarët dhe tek forcimi i qeverisjes së mirë.

Në këtë kuadër, KLSH ka integruar praktika të reja analitike dhe metodologjike, të cilat sigurojnë që identifikimi i fushave me risk të reflektojë, jo vetëm kërkesat e Kuvendit, por edhe objektivat e Planit Strategjik të institucionit. Rezultatet e analizave përmbledhen në

këtë Udhëzues, i cili ofron një panoramë të qartë të fushave që paraqesin risk për financat publike dhe institucioneve që ofrojnë shërbime për qytetarët. Në bazë të këtij dokumenti, ndërtohet plani vjetor i auditimeve të performancës, duke u fokusuar në matjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit (3E-ve) për çështjet dhe proceset e përzgjedhura.

Një element i rëndësishëm i qasjes së re është rishikimi periodik, çdo 3–5 vjet, i fushave me risk, në varësi të ndryshimeve në mjedisin e brendshëm apo të jashtëm, si dhe të faktorëve me impakt publik të lartë. Kjo përputhet me praktikën më të mira të zbatuara nga SAI të tjerë, si SHBA, Franca, Turqia, Austria, Meksika dhe Kuvajti, të cilët kanë hartuar udhëzues të ngjashëm për të orientuar punën e tyre në auditimin e jashtëm publik.

Në analizat praktike, audituesit janë të thirrur të vlerësojnë riskun mbi bazën e treguesve të identifikuar dhe informacionit të grumbulluar për çdo temë të caktuar. Kjo nënkupton zhvillimin e një pasqyre të qartë analitike mbi operacionet e qeverisë, sidomos ato me ndjeshmëri të lartë publike, që shpesh ekspozohen ndaj mashtrimit, shpërdorimit, abuzimit, keqmenaxhimit apo kanë nevojë për transformime për të përmbushur standardet e 3E-ve. Produkti final i këtij procesi duhet të listojë institucionet qeveritare, shërbimet publike dhe programet mbështetëse që paraqesin risk të lartë, duke i dhënë KLSH-së një hartë të qartë orientuese për planifikimin strategjik të auditimeve.

## **I. 2 Identifikimi i fushave/ programeve me risk të lartë në sektorin publik**

Për të kryer funksionet e tyre dhe për të garantuar vlerën potenciale që sjellin për qytetarët, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të shihen si të besueshme. Kjo arrihet vetëm nëse ato perceptohen si institucione kompetente, të pavarura dhe të përgjegjshme që udhëheqin përmes shembullit. Për këtë arsye, kërkohet zbatimi i një procesi efektiv i menaxhimit të riskut, si brenda SAI-ve, duke përfshirë risqet e integritetit, ashtu edhe të përcaktimit të fushave kryesore me risk për t'u audituar, me qëllim arritjen e objektivave të institucionit në mënyrë eficiente, efektive dhe ekonomike (3 E-të).<sup>4</sup>

Parimi 9 i Standardit Ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI - P 125 - Vlera dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit – të bësh diferencën në jetët e qytetarëve, përcakton se, për të siguruar një qeverisje të mirë brenda SAI-t, ndër të tjera, ata duhet të vlerësojnë dhe menaxhojnë rregullisht risqet e institucionit.

Parimi 5 thekson vlerën që SAI - t mund të ofrojnë, duke qenë të vetëdijshëm për ndryshimin e mjedisit dhe identifikimin e risqeve në zhvillim me të cilat përballet sektori publik. SAI-t duhet të jenë në gjendje të identifikojnë dhe menaxhojnë risqet e tyre në mënyrë që të parandalojnë çdo dëm operacional dhe strategjik që mund të ndikojë në performancën e tyre, pra të shmangin rrezikun e auditimit. Në këtë drejtim është e rëndësishme që SAI të ketë metodologji specifike të analizës që i lejojnë ata të kuptojnë problemet strukturore që prekin sektorin publik.

Nga ekzaminimi i rezultateve të auditimeve të mëparshme, është e mundur të njihen ato fusha menaxhimi që janë më të prekshme ndaj problemeve ose dështimeve të paraqitura, që do të ndikojnë në zbatimin e ligjit, përdorimin eficient të burimeve dhe arritjen e objektivave të institucionit publik. Në terma të përgjithshëm, përshtatja e kësaj qasjeje

---

<sup>4</sup> SAIs Internal Risk Management and Identification of High Risk Areas / Programs in the Public Sector (Menaxhimi i brendshëm i riskut nga SAI-t dhe identifikimi i fushave/programeve me risk të lartë në Sektorin Publik, Working Group on the Value and Benefits of Supreme Audit Institutions (WGVBS), INTOSAI, 2019

synon të sigurojë informacion të dobishëm për të ndikuar pozitivisht në fazat e ndryshme që janë pjesë e implementimit të politikave qeveritare, nëpërmjet identifikimit të fushave të përmirësimit lidhur me hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e tyre. Objektivi kryesor është dhënia e informacionit dhe rekomandimeve që çojnë në reformat e nevojshme ligjore dhe menaxheriale në administratën publike, për të shmangur përsëritjen e praktikave joeficiente dhe si një mënyrë për të përmirësuar mirëqeverisjen. Qasja tradicionale ndaj auditimit të performancës bazohet në një marrëdhënie dypalëshe ndërmjet institucionit të audituar dhe grupit të auditimit. Rezultatet kumulative të punës së kryer në subjektet e audituara mund të ofrojnë një pamje të përgjithshme të modeleve ose situatave të përsëritura, të cilat nga ana tjetër, mund të evidentojnë problemet strukturore, në veçanti fushat/programet e qeverisë. Procesi i identifikimit të fushave me risk në KLSH tashmë bazohet në kombinimin e:

- Analizës së gjetjeve të auditimeve 2022 - 2024, ku janë evidentuar mangësi të përsëritura në prokurimin publik, menaxhimin e burimeve natyrore dhe dixhitalizimin e shërbimeve.
- Konsultimit me Kuvendin dhe palët e interesit, në përputhje me Rezolutën e fundit të Kuvendit (2024), e cila ka kërkuar që KLSH të fokusohet në fushat me ndikim të drejtpërdrejtë te qytetarët.
- Qasjeve ndërkombëtare në menaxhimin e riskut (INTOSAI-P 125 dhe INTOSAI GUID 3910).

### **I. 3 Faktorët që ndikojnë në përcaktimin e risqeve**

Një fushë me risk të lartë në qeverisje dhe financat publike, mund të përkufizohet si:

- Një program ose agjenci që është në rrezik të dështimit për të përmbushur mandatin e saj ose është subjekt i mashtrimit, shpërdorimit, abuzimit ose keqmenaxhimit;
- Një model ose proces i përbashkët në funksionimin e qeverisë që nuk merr në konsideratë në mënyrë të përshtatshme eficiencën, efektivitetin, ekonomikitetin dhe pajtueshmërinë ligjore, si dhe;
- Tendanca negative në variablat e brendshme ekonomike, sociale, kulturore, politike dhe mjedisore.

Këto risqe mund të shpjegohen nga faktorë të ndryshëm:

*Dobësitë strukturore në funksionimin e institucioneve publike:*

- ✓ Sisteme të papërshtatshme të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë integritetin edhe vetëvlerësimin;
- ✓ Modele të menaxhimit publik që nuk plotësojnë nevojat e qytetarëve;
- ✓ Mangësi në aftësitë dhe kapacitetet teknike;
- ✓ Kufizimet financiare;
- ✓ Boshllëqe teknologjike;
- ✓ Çështjet e menaxhimit dhe burimeve njerëzore;
- ✓ Proceset dhe procedurat e vjetëruara;
- ✓ Besueshmëria e të dhënave;
- ✓ Lëvizjet e punonjësve pa kriter brenda njësisë publike;
- ✓ Rekrutime nepotike dhe konkurrime formale, etj.

*Hartimi dhe zbatimi i papërshtatshëm i ligjeve dhe rregulloreve:*

- ✓ Ligje të papërshtatshme me kushtet aktuale sociale, ekonomike dhe politike;

- ✓ Perceptimi i nëpunësve civilë si të pandëshkueshëm;
- ✓ Mungesa e kontrolleve dhe balancave në çështjet qeveritare;
- ✓ Vlerësimi i mangët i performancës së qeverisë;
- ✓ Mangësitë në kuadrin statutor të qeverisë;

*Kushtet e jashtme që rrjedhin nga mjedisi ndërkombëtar:*

- ✓ Ngadalësimi i ekonomisë globale;
- ✓ Ndryshimet rregullatore që prekin partnerët tregtarë;
- ✓ Tregjet ndërkombëtare dhe normat e interesit shumë të luhatshme dhe të paparashikueshme.

*Modelet ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore:*

- ✓ Çrregullimi i rendit publik në rajonet e vendit;
- ✓ Ndikimi i padrejtë politik në qeveri;
- ✓ Mungesa e besimit në sektorin publik;
- ✓ Kultura tepër burokratike;
- ✓ Mungesa e mekanizmave institucionale që lejojnë pjesëmarrjen sociale në çështjet publike dhe trajtimi i barabartë përpara ligjit;
- ✓ Mangësi në sigurinë publike, shëndetësi, energji, komunikim, arsim;
- ✓ Organizata të shoqërisë civile me aktivitet të vakët dhe pothuajse të pandjeshëm;
- ✓ Mungesë pothuajse totale e organizatave sindikaliste, etj.

#### **I. 4 Fushat me risk të identifikuar**

SAI-t mund të përdorin metodologji të ndryshme për të identifikuar fushat me risk në sektorin publik. Këto qasje mund të fokusohen në një ose disa nga aktivitetet e mëposhtme:

*Analizimi i rezultateve të auditimit për të përcaktuar modele të përsëritura, probleme të pazgjidhura dhe tendenca të vazhdueshme:*

- ✓ Analizë sasiore e bazuar në statistikat e gjetjeve të auditimit përgjatë viteve të ndryshme;
- ✓ Analizë cilësore e thelluar e gjetjeve të auditimit, duke përfshirë identifikimin e faktorëve që ndikojnë në fushat me risk;
- ✓ Përpilimi i informacionit përkatës nga burime të jashtme;
- ✓ Zbulimi i treguesve dhe tendencave sociale dhe ekonomike;
- ✓ Identifikimi i ndikimeve të mundshme në financat publike nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm;
- ✓ Përcaktimi i prioritetëve dhe kërkesave të palëve të interesuara dhe opinionit publik;
- ✓ Zbulimi i të gjitha lajmeve, informacioneve, intervistave, etj., të cilat publikohen në media.

*Kryerja e sondazheve ose grupeve të fokusit me palë të interesuara si:*

- ✓ Deputetët
- ✓ Organizatat joqeveritare
- ✓ Media
- ✓ Akademia dhe stafe akademike në njësitë publike

- ✓ Subjektet e audituara
- ✓ Departamentet e tjera qeveritare
- ✓ Shoqëria në përgjithësi, si dhe
- ✓ Donatorët.

KLSH, në varësi të burimeve të disponueshme, kapaciteteve teknike dhe mandatit ligjor, mund të përdorë një ose më shumë nga këto opsione. Produkti i pritshëm i këtij procesi është identifikimi dhe krijimi i hartës së zonave me risk në të gjithë sektorin publik. Ky informacion mund t'u dorëzohet palëve përkatëse të interesit për arsye se mund të shërbejë si një kontribut i rëndësishëm për punën legjislative, buxhetimin publik, vlerësimet e programeve dhe politikave, planifikimin e auditimeve, prioritizimin e veprimeve qeveritare, kërkimet dhe studimet akademike. Në vijim të analizës së thelluar kryer nga KLSH, specifikisht Departamenti i Auditimit të Performancës, nëpërmjet punës audituese bazuar në pesë shtylla orientuese; analizës së riskut, ndjeshmërisë publike, qëndrimit ndërkombëtar dhe kriterëve të tjera të sipërpërmendura, janë identifikuar dhe vlerësuar fushat me risk, si më poshtë:

Fushat/programe me risk të lartë të identifikuara janë:

- 1. Arsimi dhe aftësimi profesional** – cilësia e arsimit, gjithëpërfshirja, financimi dhe digjitalizimi.
- 2. Shëndetësia dhe mbrojtja sociale** – financimi i shëndetësisë, aksesueshmëria, shëndeti mendor, barnat, pajisjet mjekësore, shërbimet shëndetësore në të gjitha nivelet;
- 3. Mbledhja e të ardhurave** – performanca e tatimeve dhe doganave, dixhitalizimi i sistemit fiskal;
- 4. Infrastruktura** – transporti publik, siguria e digave, projektet e mëdha investuese;
- 5. Mjedisi** – menaxhimi i mbetjeve, ndotja e ajrit dhe ujërave, ndryshimet klimatike, menaxhimi i emergjencave civile etj;
- 6. Energjia** – siguria energjetike, tranzicioni drejt burimeve të rinovueshme;
- 7. Tregu i punës** – papunësia e të rinjve, emigracioni, mungesa e aftësive;
- 8. Administrata publike** – transparenca, dixhitalizimi, integriteti, duke përfshirë këtu edhe sigurinë kibernetike dhe dixhitalizimi i shërbimeve publike, si çështje e re me risk, me ndikim direkt tek qytetarët.

## II. ANALIZA E FUSHAVE ME RISK

### II.1 ARSIMI

Arsimi përbën një nga sektorët më strategjikë të zhvillimit të vendit, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien sociale, në tregun e punës dhe në perspektivën ekonomike. Për shkak të kësaj rëndësie, ai është në qendër të vëmendjes së institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile. Vlerësimet dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë, si Komisioni Evropian, OECD, UNESCO, UNICEF dhe Banka Botërore, theksojnë domosdoshmërinë e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, cilësor dhe të përputhur me standardet evropiane. Këto organizata kanë kontribuar me analiza të gjendjes, mbështetje financiare dhe teknike, si dhe me orientime për politika publike më efektive. Megjithatë, dinamika e zhvillimeve shoqërore, ekonomike dhe teknologjike e ekspozon arsimin ndaj një sërë rreziqesh që lidhen me cilësinë, financimin, barazinë në akses dhe qeverisjen. Identifikimi i këtyre rreziqeve është i domosdoshëm për të orientuar auditimet publike drejt fushave me impakt më të madh. Ky kapitull përmbledh analizën e gjendjes aktuale të arsimit, evidenton faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në këtë sektor dhe paraqet fushat prioritare që kërkojnë vëmendje të shtuar nga audituesit.

Për sektorin e arsimit në Shqipëri, përgjegjësia institucionale i takon Ministrisë së Arsimit (MA)<sup>5</sup>. Ky institucion ka rol qendror në hartimin e vizionit kombëtar për arsimin, në përcaktimin e strategjive dhe planeve të zhvillimit, si dhe në mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. MAS është institucioni që përfaqëson shtetin shqiptar edhe në bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare në fushën e arsimit, si Bashkimi Evropian, UNESCO, UNICEF, OECD apo Banka Botërore. Përmes këtij bashkëpunimi, arsimit në Shqipëri përfiton nga praktikat më të mira ndërkombëtare dhe nga mbështetja teknike e financiare.

#### Vizioni strategjik

Vizioni i përcaktuar nga MAS, i formalizuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, synon ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, cilësor dhe të drejtë, i cili respekton diversitetin dhe garanton barazinë në akses për të gjithë fëmijët, nxënësit dhe studentët. Ky vizion përkthehet në tri qëllime themelore të politikave:

- Sigurimi i një arsimit parauniversitar cilësor dhe gjithëpërfshirës, që i pajis nxënësit me njohuri, shkathtësi dhe vlera për jetën demokratike dhe zhvillimin personal.
- Krijimi i një menaxhimi efektiv e efikas të sistemit arsimor, duke vendosur mekanizma të fortë për cilësinë, transparencën dhe llogaridhënien.
- Zhvillimi i një arsimit të lartë gjithëpërfshirës dhe me standarde ndërkombëtare, që respekton integritetin akademik dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit.

Në kuadër të integritimit evropian, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 është hartuar në përputhje me katër objektivat strategjike të Kornizës “Edukimi dhe Trajnimi 2020”:

- të nxënit gjatë gjithë jetës dhe nxitja e mobilitetit;
- përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të arsimit e formimit;
- promovimi i barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive;

---

<sup>5</sup> Ministria e Arsimit. *Misioni dhe vizioni*. Tiranë. <https://arsimi.gov.al>

Ministria e Arsimit (MA) është institucioni qendror përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare në fushën e arsimit parauniversitar, arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Ajo harton dhe propozon bazën ligjore, strategjitë dhe programet e zhvillimit arsimor, si dhe mbikëqyr institucionet në varësi të saj. Për zbatimin e politikave arsimore, Ministria e Arsimit dhe Sportit mbështetet në disa agjenci të specializuara.

- **Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP)**<sup>6</sup> ka mision të garantojë cilësinë në arsimin parauniversitar. Ajo merret me inspektimin e shkollave, me mbikëqyrjen e standardeve të mësimdhënies dhe me sigurimin e një arsimit të barabartë e gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit.
- **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)**<sup>7</sup> ka për detyrë zhvillimin e kurrikulës, standardeve dhe teksteve shkollore, si dhe trajnimin e mësuesve. Ajo mbështet politikat arsimore dhe siguron përafrimin e arsimit parauniversitar me zhvillimet bashkëkohore.
- **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL)**<sup>8</sup> është përgjegjëse për procesin e akreditimit të universiteteve dhe programeve të studimit. Roli i saj është thelbësor për garantimin e integritetit akademik dhe përafrimin e arsimit të lartë me standardet evropiane.
- **Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)**<sup>9</sup> administron provimet kombëtare, maturën shtetërore dhe testimet e tjera standardizuese. Përmes saj sigurohet objektiviteti dhe barazia në vlerësimin e nxënësve në shkallë kombëtare.
- **Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)**<sup>10</sup> ka si mision të mbështesë zhvillimin e arsimit dhe formimit profesional. Ajo merret me hartimin e kurrikulës kombëtare, përcaktimin e standardeve të kualifikimeve dhe përafrimin me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.
- **Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)**<sup>11</sup> ka për mision mbështetjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor e inovacionit në Shqipëri, duke financuar dhe monitoruar projektet në këtë fushë.

Sistemi arsimor shqiptar është i organizuar në tre nivele kryesore: arsimit parauniversitar, arsimit të lartë dhe arsimit profesional.

- **Arsimi parauniversitar**<sup>12</sup> përfshin arsimin parashkollor (3–6 vjeç), arsimin fillor (klasat I–V), arsimin e mesëm të ulët (klasat VI–IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (gjimnazet dhe shkollat e mesme profesionale). Ky nivel synon të sigurojë arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët, duke formuar identitetin personal, kombëtar dhe qytetar, si dhe duke nxitur zhvillimin intelektual, etik, fizik, estetik e

<sup>6</sup> VKM Nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar

<sup>7</sup> VKM Nr. 98, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”

<sup>8</sup> Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”

<sup>9</sup> Vendim nr. 371, datë 26.4.2017 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve

<sup>10</sup> VKM Nr. 199, datë 11.4.2018, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”

<sup>11</sup> VKM Nr. 607, datë 31.08.2016 “Për Krijimin, Përbërjen, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit”.

<sup>12</sup> Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

social të tyre. Ai përgatit nxënësit për jetën dhe tregun e punës, duke i pajisur me aftësi për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për të përdorur teknologjitë bashkëkohore (Ligji nr. 69/2012, neni 2 dhe neni 4).

- **Arsimi i lartë**<sup>13</sup> përfshin universitetet publike dhe jopublike, akademitë e specializuara, kolegjet e larta, shkollat e larta profesionale dhe institucionet e kërkimit shkencor. Ky nivel ka për qëllim të ofrojë zhvillim të plotë intelektual, profesional dhe etik për studentët, të kontribuojë në forcimin e shoqërisë demokratike dhe qytetarisë aktive, si dhe të gjenerojë dhe përhapë dije përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe inovacionit. Njëkohësisht, ai synon të garantojë mundësi të barabarta për të gjithë, të mbështesë zhvillimin ekonomik, kulturor e social të vendit dhe të sigurojë integrimin në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, në përputhje me Procesin e Bolonjës. Po ashtu, arsimi i lartë ka si objektive të nxisë kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik si pjesë të pandashme të procesit akademik (Ligji nr. 80/2015, nenet 3–4).
- **Arsimi dhe formimi profesional (AFP)**<sup>14</sup> ofrohet si në nivelin e mesëm, ashtu edhe në nivelin e lartë profesional, duke orientuar të rinjtë drejt tregut të punës. Ky nivel synon t'i pajisë nxënësit dhe studentët me aftësi praktike e profesionale, të nxisë punësimin përmes kualifikimeve të njohura, si dhe të mbështesë formimin gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional. AFP shihet si një element i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik e social të vendit (Ligji nr. 15/2017).

### Qëndrimi ose këndvështrimi ndërkombëtar

Sipas rezultateve të PISA 2022 të publikuara nga OECD, nxënësit shqiptarë shënuan një rënie të ndjeshme në aftësitë bazë të matematikës, leximit dhe shkencës krahasuar me vitin 2018 (OECD, 2023)<sup>15</sup>. Megjithatë, një element pozitiv i evidentuar në raportin për Shqipërinë është se, 85% e nxënësve shqiptarë ndihen të lidhur me shkollën e tyre, më shumë se mesatarja e OECD-së prej 75% (OECD, 2023). Po ashtu, broshura mbi Mendimin Krijues e PISA 2022 (qershor 2024) nënvizon nevojën për zhvillimin e metodave mësimore më inovative dhe krijuese, duke theksuar se kreativiteti është një nga kompetencat kyçe për të ardhmen (OECD, 2024).

Edhe UNICEF<sup>16</sup> ka vënë në dukje sfida të rëndësishme. Në raportin vjetor 2024 theksohet se shpenzimet publike për arsimin në Shqipëri arritën vetëm në 2.1% të PBB-së, një nivel dukshëm më i ulët se mesatarja rajonale (UNICEF, 2024). Për të adresuar këtë situatë, UNICEF ka mbështetur projektin *Equitable School Infrastructure* në 100 shkolla të gjashtë bashkive, duke synuar përmirësimin e kushteve fizike dhe të rezultateve mësimore. Po ashtu, në vitin 2023 janë trajnuar mbi 550 mësues dhe drejtues shkollash për arsimin parashkollor, duke promovuar përdorimin e platformës digjitale **Akademi.al** (UNICEF, 2024).

Nga ana tjetër, Banka Botërore<sup>17</sup> në raportin *Better Education for Stronger Economic Growth* (dhjetor 2024) vlerëson se Shqipëria ka bërë përparim në rritjen e aksesit në

<sup>13</sup> Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”

<sup>14</sup> Ligji nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”

<sup>15</sup> [https://www.oecd.org/en/publications/pisa-2022-results-volume-i-and-ii-country-notes\\_ed6fbcc5-en/albania\\_1ccc35b9-en.html?utm\\_source=chatgpt.com](https://www.oecd.org/en/publications/pisa-2022-results-volume-i-and-ii-country-notes_ed6fbcc5-en/albania_1ccc35b9-en.html?utm_source=chatgpt.com)

<sup>16</sup> UNICEF ALBANIA. Annual Report 2024, PDF

<sup>17</sup> Banka Botërore. *Europe and Central Asia Economic Update – Fall 2024: Better Education for Stronger Growth*. Dhjetor 2024.

arsimin e lartë, por cilësia e tij dhe lidhja me tregun e punës mbeten sfida të theksuara që kërkojnë ndërhyrje të qëndrueshme (World Bank, 2024).

Së fundi, Komisioni Evropian<sup>18</sup>, në Raportin e Progresit për Shqipërinë (tetor 2024), nënvizon se arsimi mbetet një nga fushat me progres të kufizuar, duke evidentuar nevojën për rritje të financimit, përmirësim të cilësisë së mësimdhënies dhe zbatim të plotë të Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026 (Komisioni Evropian, 2024).

### Auditime të KLSH

Gjatë viteve të fundit, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), duke njohur rolin strategjik të arsimit në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit, ka përfshirë këtë sektor në mënyrë të qëndrueshme në planet e tij të auditimit. Ky orientim nuk ka qenë vetëm pasojë e rëndësisë që arsimi ka në zhvillimin kombëtar, por ka reflektuar edhe shqetësimet e ngritura nga publiku, gjetjet e konstatuara gjatë proceseve të mëparshme audituese, si dhe rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë. Një ndikim të veçantë kanë pasur gjithashtu udhëzimet dhe prioritetet e përcaktuara nga organizatat ndërkombëtare të auditimit, si INTOSAI dhe EUROSAI, të cilat kanë orientuar fokusin drejt sektorëve me impakt të lartë publik. Po ashtu, proceset e integritetit evropian dhe përdorimi i fondeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit kanë kontribuar në zgjerimin e vëmendjes ndaj këtij sektori. Në këtë kontekst, auditimet e KLSH-së në fushën e arsimit kanë synuar të ofrojnë një analizë gjithëpërfshirëse mbi hartimin dhe zbatimin e politikave arsimore, planifikimin dhe përdorimin e burimeve financiare, menaxhimin e stafit dhe zhvillimin profesional, gjendjen e infrastrukturës dhe pajisjeve arsimore, cilësinë e rezultateve dhe performancën institucionale, si dhe funksionimin e mekanizmave të transparencës, monitorimit dhe llogaridhënies.

Disa prej auditimeve kryesore të realizuara në sektorin e arsimit janë si më poshtë:

- Auditimi *“Sistemi arsimor parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara”*<sup>19</sup>, i realizuar në vitin 2022, kishte për qëllim vlerësimin e efektivitetit të politikave arsimore, zbatimin e standardeve të përfshirjes dhe cilësinë e shërbimeve mbështetëse në institucionet publike. U identifikuan mungesa në strategji të integruar, staf të paformuar, infrastrukturë të papërshtatshme dhe mekanizma të dobët monitorimi. Rekomandimet përfshijnë përmirësimin e kornizës ligjore, forcimin e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm raportimi për progresin e nxënësve me nevoja të veçanta.
- Auditimi *“Orientimi për karrierë i të rinjve në sistemin arsimor parauniversitar”*<sup>20</sup>, po ashtu i realizuar në vitin 2025, synoi të vlerësonte mënyrën se si institucionet arsimore adresojnë nevojat e nxënësve për udhëzim profesional. U evidentua mungesë vizioni strategjik, struktura të paformalizuara, fonde të pamjaftueshme dhe bashkëpunim sporadik me aktorët lokalë. KLSH rekomandoi rishikim të kuadrit ligjor, ngritje strukturash të dedikuara dhe krijim mekanizmash të qëndrueshëm bashkëpunimi me sektorin privat dhe komunitetin<sup>1</sup>.

<sup>18</sup> European Commission. *Albania 2024 Report*. Enlargement Package, October 2024.

<sup>19</sup> <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-i-auditimit-te-performances-me-teme-sistemi-arsimor-parauniversitar-per-femijet-me-aftesi-te-kufizuara/>

<sup>20</sup> <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-auditimi-orientimi-per-karriere-i-te-rinjve-ne-sistemin-arsimor-parauniversitar/>

- Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër <sup>21</sup>, i kryer në vitin 2025, kishte për qëllim vlerësimin e menaxhimit institucional, transparencës financiare dhe cilësisë së shërbimeve akademike. U konstatuan dobësi në planifikim strategjik, menaxhim fondesh dhe vlerësim cilësie. Rekomandimet përfshijnë riorganizim institucional, përmirësim të menaxhimit financiar dhe zhvillim të një sistemi të qëndrueshëm të vlerësimit akademik<sup>1</sup>.
- Auditimi “Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë”<sup>22</sup>, i kryer 2025, shqyrtoi periudhën 2023–2024 dhe vlerësoi funksionimin, sigurinë dhe qeverisjen e sistemeve IT. U evidentuan mungesa në staf të kualifikuar, dokumentacion rregullator dhe masa sigurie. Rekomandimet përfshijnë hartim politikash IT, instalim të fireë all-it, ndalim të llogarive të përbashkëta dhe trajnime për stafin<sup>1</sup>.
- Auditimi “Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Universitetin ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër”<sup>23</sup>, i zhvilluar në vitin 2022, shqyrtoi veprimtarinë për vitet 2023–2024. U konstatuan mungesa në strukturë të dedikuar, dokumentacion dhe siguri fizike e digjitale. KLSH rekomandoi krijimin e strukturës për TI, hartim të rregulloreve, përmirësim të sigurisë dhe trajnime për stafin akademik dhe administrativ.
- Raport përfundimtar i auditimit mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në qendrën e arsimit Lushnje prill 2025. Auditimi në Qendrën e Arsimit Lushnje<sup>24</sup> u përfundua në vitin 2025, duke mbuluar periudhën audituese nga 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2024. Gjetjet kryesore përfshijnë mungesën e një strategjie dhe plani për teknologjinë e informacionit, mos hartimin e regjistrit të riskut, mungesën e sektorit dhe stafit të specializuar për TI, infrastrukturë të amortizuar dhe pajisje të pasigurta, si dhe shkelje në menaxhimin e sistemeve të kamerave dhe transparencën institucionale. Rekomandimet përmirësuese përfshijnë hartimin e një plani strategjik për TI, ngritjen e sektorit përkatës, përmirësimin e rregulloreve të brendshme, trajnimin e stafit, përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe garantimin e transparencës në publikimin e të dhënave.
- Raporti përfundimtar “Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Universitetin e Tiranës – Fakulteti i Sporteve”<sup>25</sup> u hartua në vitin 2022 dhe mbulon periudhën e auditimit nga janari 2022 deri në dhjetor 2023. Auditimi kishte për qëllim vlerësimin e funksionalitetit, sigurisë dhe përputhshmërisë së sistemeve TI, në mbështetje të proceseve akademike dhe administrative të fakultetit. Gjetjet kryesore përfshijnë mungesën e një strategjie të integruar për TI, dobësi në kontrollat e aksesit dhe ruajtjes së të dhënave personale të studentëve dhe stafit, si dhe mungesë të procedurave të dokumentuara për backup, rikuperim pas fatkeqësive dhe mirëmbajtje sistemore. Rekomandimet përfshijnë hartimin e një politike institucionale për TI të

<sup>21</sup> <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-auditimi-i-ushtruar-ne-universitetin-luigj-gurakuqi-shkoder/>

<sup>22</sup> <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-mbi-auditimin-e-sistemeve-te-teknologjise-se-informacionit-ne-drejtorene-rajonale-te-arsimit-parauniversitar-lezhe/>

<sup>23</sup> <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-mbi-auditimin-e-sistemeve-te-teknologjise-se-informacionit-ne-universitetin-e-shkodres-luigj-gurakuqi/>

<sup>24</sup> <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-mbi-auditimin-e-sistemeve-te-teknologjise-se-informacionit-ne-qendren-e-arsimit-lushnje/>

<sup>25</sup> <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-mbi-auditimin-e-sistemeve-te-teknologjise-se-informacionit-ne-universitetin-e-tiranes/>

përshtatur për nevojat specifike të fakultetit, forcimin e mekanizmave të sigurisë sipas ISO 27001, trajnimin e stafit për përdorimin dhe administrimin e sistemeve, si dhe krijimin e një strukture të dedikuar për menaxhimin e TI në nivel fakulteti.

- Raporti përfundimtar mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Universitetin e Tiranës<sup>26</sup>, i përfunduar në vitin 2022, mbulon periudhën auditore 2020–2022 dhe ofron një vlerësim të thelluar mbi funksionimin, sigurinë dhe përputhshmërinë e infrastrukturës TI me standardet dhe rregulloret përkatëse. Auditimi ka synuar të analizojë organizimin institucional të teknologjisë së informacionit, sistemet e menaxhimit të të dhënave akademike dhe administrative, si dhe masat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë kibernetike. Gjetjet tregojnë mangësi në dokumentimin e procedurave, kontrollin e aksesit dhe menaxhimin e rreziqeve, si dhe nevojën për përmirësim të kapaciteteve teknike dhe organizative. Rekomandimet përfshijnë forcimin e politikave të sigurisë, përmirësimin e dokumentacionit teknik dhe operacional, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimit të stafit për përdorimin e sistemeve TI në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Ky raport përbën një bazë të rëndësishme për vendimmarrje institucionale dhe për hartimin e strategjive të zhvillimit teknologjik në arsimin e lartë publik.
- Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”<sup>27</sup>, i zhvilluar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën 2020–2021 dhe i përfunduar në vitin 2022, evidentoi mungesën e një plani strategjik TIK, rregullore të përditësuar, regjistri risku dhe plane për rikuperim nga katastrofat, si dhe fragmentim të sistemeve informatike me përdorim paralel të Pitagora dhe SMAK. Backup-et kryhen manualisht pa testim rikuperimi, dhoma e serverëve nuk përmbush standardet e sigurisë, dhe menaxhimi i përdoruesve është informal, pa dokumentim apo udhëzues. KLSH konkludoi se përdorimi aktual i sistemeve mbart risk të lartë për funksionimin institucional dhe rekomandoi masa për përmirësimin e qeverisjes TIK, konsolidimin e sistemeve, ngritjen e infrastrukturës së sigurisë dhe formalizimin e procedurave kritike.

Auditimet e realizuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në fushën e arsimit përfaqësojnë një angazhim të qëndrueshëm për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet institucionale që ndikojnë në cilësinë, transparencën dhe efektivitetin e sistemit arsimor. Nëpërmjet analizës së praktikave konkrete dhe vlerësimit të zbatimit të politikave, këto auditime evidentojnë mangësitë që përbëjnë rrezik për funksionimin normal të institucioneve, si p.sh. dobësi në menaxhimin e sistemeve IT, mungesë kontrollesh të brendshme apo paqartësi në ndarjen e përgjegjësiave. Gjetjet e mbështetura në evidenca synojnë të ofrojnë rekomandime të zbatueshme, të cilat jo vetëm adresojnë rreziqet e identifikuar, por edhe ndihmojnë në ndërtimin e mekanizmave të parandalimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm. *Kësisoj, rezultatet e auditimit shërbejnë si bazë për vendimmarrje të informuar dhe për politika që menaxhojnë rrezikun në mënyrë të strukturuar, të matshme dhe të përputhshme me standardet ndërkombëtare të qeverisjes dhe kontrollit.*

<sup>26</sup> <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-mbi-auditimin-e-sistemeve-te-teknologjise-se-informacionit-ne-universitetin-e-tiranes/>

<sup>27</sup> <https://www.klsh.org.al/raport-perfundimtar-mbi-auditimin-e-sistemeve-te-teknologjise-se-informacionit-ne-universitetin-e-shkodres-luigj-gurakuqi/>

## Të tjera

Bazuar në analizat e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, rezultatet e PISA 2022, Raportin e Progresit të BE-së (2024), raportet e UNICEF dhe Bankës Botërore (2024), të dhënat e raportimeve kombëtare, si dhe gjetjet e auditimeve të KLSH, janë identifikuar fushat kryesore të riskut në sektorin e arsimit.

## Arsimi Parauniversitar

- Cilësia e të nxënit dhe rezultatet në testime ndërkombëtare – rënie e dukshme në PISA 2022 në matematikë, shkencë dhe lexim; dobësi në zbatimin e kurrikulës dhe formimin e mësuesve.
- Braktisja dhe ulja e regjistrimeve – numri i nxënësve bie për shkak të migrimit dhe demografisë; shkalla e braktisjes mbi mesataren e BE-së.
- Gjithëpërfshirja – ndonëse është rritur numri i mësuesve ndihmës, mbeten probleme me aksesin dhe planifikimin individual për nxënësit me nevoja të veçanta.
- Kurrikula dhe sistemi i vlerësimit – nevojë për rishikim të Maturës Shtetërore dhe forcim të përdorimit të vlerësimit formues.
- Digjitalizimi dhe infrastruktura teknologjike – futja e TIK në kurrikul nuk shoqërohet me pajisje dhe akses të mjaftueshëm në internet, sidomos në shkollat rurale.
- Infrastruktura shkollore – investimet janë të pakta dhe me vonesa, duke ndikuar në kushte të pabarabarta të të nxënit.
- Financimi – shpenzimet publike nën mesataren rajonale/BE, duke ndikuar në cilësinë e arsimit.
- Arsimi i hershëm – mbulesa dhe standardet e çerdheve/kopshteve janë të pabarabarta, sidomos në zonat rurale.

## Arsimi i Lartë

- Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi – ndikimi i kufizuar i procesit të akreditimit në performancën reale të universiteteve.
- Kërkimi shkencor dhe inovacioni – financim minimal; pjesëmarrje e ulët e sektorit privat; dobësi në integrimin me Zonën Evropiane të Kërkimit.
- Integriteti akademik – mungesë sistemi të unifikuar për parandalimin e plagjiaturës.
- Financimi i arsimit të lartë – mbështetje tradicionale, jo mbi bazë performance; probleme me bursat e ekselencës.
- Ndërkombëtarizimi – mobilitet i ulët i studentëve dhe stafit; bashkëpunim ndërkombëtar i kufizuar.
- Autonomia dhe qeverisja – autonomia formale, por e dobët në praktikë; mungesë mekanizmash të fortë llogaridhënieje dhe financimi të qëndrueshëm.
- Raportimi i performancës – mungon analizë vjetore e standardizuar; gjendja e sektorit reflektohet vetëm në dokumente të veçanta (p.sh. Politikat 2030).

## Fusha të përbashkëta për të gjithë sektorin e Arsimit

- **Cilësia e arsimit dhe rezultatet e nxënësve** - rezultate të ulëta në PISA, diferencë midis aftësive dhe tregut të punës, mungesë standardesh uniforme në arsimin e lartë.
- **Financimi dhe përdorimi i fondeve publike** – buxhetim i ulët dhe shpërndarje joefikase që ndikon në cilësinë dhe barazinë në arsim.

- **Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe trajnimi i mësuesve/pedagogëve** – mungesa e specialistëve, shpërndarja e pa balancuar dhe trajnimi i pamjaftueshëm.
- **Infrastruktura dhe teknologjia** - shkolla me kushte të dobëta fizike, mungesë laboratorësh, përdorim i ulët i TIK.
- **Gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim** – vështirësitë për fëmijët me nevoja të veçanta, për komunitetet rom dhe egjiptian dhe për nxënësit në zonat rurale mbeten të theksuara.
- **Mekanizmat e monitorimit, kontrollit dhe llogaridhënies** – dobësi në sistemet e monitorimit, raportim jo i plotë mbi cilësinë dhe shpenzimet, mungesë transparence.

Evidentimi i këtyre fushave në këtë dokument synon të ofrojë një kuadër të qartë dhe të strukturuar mbi zonat më të ndjeshme të sistemit arsimor, duke krijuar bazën për ndërhyrje të qëndrueshme, rritje të transparencës dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në Shqipëri.

## II. 2 SHËNDETËSIA DHE MBROJTJA SOCIALE

### Vizioni strategjik i ministrisë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është institucioni shtetëror që mbulon hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor. Është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.

### II. 2. 1 SHËNDETËSIA

Vizioni strategjik i Ministrisë në fushën e shëndetësisë është konsoliduar në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021 - 2030<sup>28</sup>.

Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 është konceptuar si një strategji, e cila jep kontributin e saj në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, nëpërmjet konkretizimit të objektivit 11.2 të saj “*Një sistem më i fortë dhe më i aksesueshëm për kujdesin shëndetësor*”, si më poshtë:

- Përmirësimi i cilësisë së kujdesit shëndetësor, duke garantuar akses të plotë për të gjithë personat që jetojnë në Shqipëri, sipas një sistemi të qëndrueshëm financiar;
- Rritja e numrit të viteve të shëndetshëm të jetës së popullsisë shqiptare;
- Modernizimi i infrastrukturës dhe rritja e sigurisë dhe cilësisë së kujdesit spitalor;
- Rritja e cilësisë dhe sigurisë së barnave, në përputhje me standardet evropiane;
- Zhvillimi i një qasjeje të integruar dhe më të mirë koordinuar të kujdesit shëndetësor; dhe
- Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë dhe rikthimi i besimit të publikut të gjerë në sistemin e kujdesit shëndetësor.

**Misioni i strategjisë** është:

- Mbrojtja, përmirësimi dhe promovimi i shëndetit.

<sup>28</sup> VKM nr. 210, datë 06.04.2022 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021 – 2030”.

- Rritja e mirëqenies dhe produktivitetit të të gjithë qytetarëve në Shqipëri.
- Garantimi i ofrimit të kujdesit shëndetësor cilësor në kohë dhe të përballueshëm për popullatën shqiptare.
- Sigurimi i progresit të qëndrueshëm në shëndetin publik dhe kujdesin shëndetësor.
- Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit shëndetësor për emergjencat dhe shfrytëzimi i inovacioneve dhe integritit të kujdesit për fuqizimin e sistemit shëndetësor.

**Parimet e përgjithshme** që udhëheqin strategjinë:

- Mosdiskriminimi;
- Interesi më i mirë i pacientëve;
- Për shëndetin, për mirëqenien fizike, mendore dhe sociale (përkufizim i OBSH-së);
- Gjithëpërshirja;
- Pjesëmarrja.

**Vlerat:** Universaliteti, qëndrueshmëria, cilësia, qendërzimi i individit, përqendrimi ndaj shëndetit si një e mirë njerëzore dhe publike, inovacioni, integriteti, efikasiteti dhe efektiviteti i sistemit, transparenca, llogaridhënia, dinjteti, barazia gjinore dhe përfshirja. Duke u bazuar në Analizën e Strategjisë 2016 - 2020, në vazhdimësinë e zbatimit të prioriteteve të kësaj strategjie, si dhe në identifikimin e nevojave aktuale të sistemit shëndetësor në Shqipëri, janë identifikuar 5 (pesë) prioritet strategjike të lidhura me qëllimet e strategjisë SKSH 2030, të cilat janë:

- Investimi në shëndetin e njerëzve gjatë ciklit të jetës;
- Progresi drejt mbulimit Universal Shëndetësor;
- Fuqizimi i sistemit të integruar shëndetësor;
- Fuqizimi i reagimit të sistemit ndaj emergjencave;
- Përmirësimi i shëndetit të nënës dhe fëmijës, adoleshentëve, si dhe shëndeti seksual dhe riprodhues;
- Shëndeti digjital.

### **Fushat në të cilat shtrihet veprimtaria e ministrisë në shëndetësi**

Legjislacioni shqiptar në fushën e shëndetësisë mbulon një gamë të gjerë fushash, duke nisur nga kujdesi shëndetësor bazë, barnat dhe shërbimi farmaceutik, sigurimet shëndetësore dhe shërbimi publik sanitar, deri tek fusha më të ndjeshme si autopsitë, transplantimi i organeve, ndërprerja e shtatzënisë, shëndeti riprodhues, shëndeti mendor dhe kujdesi paliativ. Po aq të rëndësishme janë edhe rregullimet për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, menaxhimin e kimikateve, kontrollin e substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse, HIV/AIDS-it dhe infeksioneve të tjera.

Ligjet trajtojnë gjithashtu mbrojtjen e shëndetit publik nga produktet e duhanit dhe alkoolit, parandalimin e çrregullimeve ushqyese si mungesa e jodit, nxitjen e ushqyerjes me gji dhe sigurinë ushqimore. Në kuadër të garantimit të cilësisë së shërbimit, janë parashikuar ligje për pajisjet mjekësore, shërbimin e urgjencës, transfuzionin e gjakut, shërbimin stomatologjik dhe statistikat zyrtare në shëndetësi. Një aspekt tjetër i veçantë lidhet me funksionimin e urdhrave profesionalë të mjekëve, infermierëve, farmacistëve dhe stomatologëve, duke rritur llogaridhënien dhe etikën profesionale.

Së fundmi, përmes ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe financimit të projekteve për modernizimin e sistemit shëndetësor, legjislacioni përpiqet të harmonizohet me praktikat më të mira globale, duke adresuar fushat me risk që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e popullsisë.

### **Auditimet e performancës në shëndetësi**

Gjatë viteve të fundit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë auditimeve të performancës me tematika të lidhura drejtpërdrejt me shëndetësinë, duke i konsideruar këto si fusha me risk të lartë dhe me ndjeshmëri të veçantë publike. Nëpërmjet këtyre auditimeve, KLSH ka evidentuar problematikat kryesore që lidhen me funksionimin e sistemit shëndetësor, si nënfinancimi i kujdesit parësor, shpërndarja e pabarabartë e burimeve njerëzore dhe mjekësore, akses i kufizuar për grupet vulnerabël, mangësi në infrastrukturë dhe pajisje, si dhe probleme me menaxhimin e fondeve publike dhe procesin e prokurimeve në sektorin shëndetësor. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar gjithashtu shërbimeve të urgjencës mjekësore, shërbimeve spitalore, menaxhimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, shërbimeve stomatologjike dhe mbrojtjes së shëndetit publik nga sëmundjet ngjitëse dhe faktorët e mjedisit.

Auditimet e performancës me tematika shëndetësore kanë gjeneruar impakt të ndjeshëm në publik dhe media, duke nxitur debat dhe reflektim mbi nevojën për reforma të thella strukturore në sistemin shëndetësor. Ato kanë sjellë në vëmendje mangësitë në zbatimin e ligjeve dhe strategjive shëndetësore, boshllëqet në bashkëpunimin ndërinstitucional, si dhe mungesën e planeve afatgjata për modernizimin dhe digjitalizimin e shërbimeve. Përmes rekomandimeve të dhëna, KLSH ka synuar të forcojë llogaridhënien, të përmirësojë menaxhimin e resurseve dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më cilësore e të aksesueshme për qytetarët.

### **Fushat me risk në shëndetësi**

Referuar raporteve dhe studimeve të fundit në fushën e shëndetësisë, në vendin tonë, ka rezultuar se fushat emergjente me risk që mund të merren në konsideratë për të ideuar dhe propozuar tema të mundshme auditimi janë:

- Nënfinancimi i kujdesit shëndetësor, sidomos kujdesit parësor, i cili çon në mungesë shërbimesh cilësore dhe të mjaftueshme.<sup>29</sup>
- Shpenzimet shëndetësore nga qytetarët (out of pocket expenditures) - shumë njerëz detyrohen të paguajnë vetë shërbime, barna, ose shërbime shtesë, gjë që mund të jetë katastrofike financiarisht për familjet me të ardhura të ulëta.<sup>30</sup>
- Menaxhimi dhe mungesë transparence në prokurime, kontrata publike, shpërndarjen e fondeve dhe materialeve, që sjell inefficiencë dhe shpesh korrupsion.<sup>31</sup>
- Barriera në aksesin për grupet vulnerabël, si banorët e zonave rurale, të moshuarit, persona me lëvishmëri të kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuar të përhershme,

<sup>29</sup> [https://www.who.int/about/accountability/results/who-results-report-2024-2025/country-profile/2024/albania?utm\\_source=chatgpt.com](https://www.who.int/about/accountability/results/who-results-report-2024-2025/country-profile/2024/albania?utm_source=chatgpt.com)

<sup>30</sup> [https://www.reporter.al/2024/11/06/sistemi-shendetesor-shqiptar-vuan-nga-buxhetimi-i-ulet-thekson-raporti/?utm\\_source=chatgpt.com](https://www.reporter.al/2024/11/06/sistemi-shendetesor-shqiptar-vuan-nga-buxhetimi-i-ulet-thekson-raporti/?utm_source=chatgpt.com)

<sup>31</sup> Raporti i "Together for Life" mbi prokurimet publike në sektorin e shëndetësisë (viti 2024) <https://www.togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2025/05/Raport-mbi-Prokurimet-publike-ne-sektorin-e-shendetesise-per-vitin-2024.pdf>

për shkak të transportit, distancës, orareve apo infrastrukturës së dobët.<sup>32</sup>

- Mungesa e mjekëve ose personelit mjekësor, shpesh i shpërndarë jo në mënyrë të barabartë, dhe emigrimi i profesionistëve drejt vendeve të tjera.<sup>33</sup>
- Probleme me prokurimin e barnave dhe materialeve, duke përfshirë vonesa, produkte jashtë standardit ose afate skadimi, bashkë me mungesën e konkurrencës dhe konfliktin e interesit.<sup>34</sup>
- Nevoja për reformë spitalore, për autonomi, organizim më të mirë, standarde më të larta të menaxhimit dhe eficiencë të shërbimeve spitalore.<sup>35</sup>
- Përgatitja për emergjenca shëndetësore dhe kapaciteti për t'u përballur me sëmundje infektive, pandemitë, dhe çështje të tjera që mund të shfaqen papritur.

### Qëndrimi ose këndvështrimi ndërkombëtar në fushën e shëndetësisë

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm e konsideron shëndetin si një nga shtyllat kryesore për të ardhmen globale. Ky objektivi kërkon përkushtim të përbashkët nga të gjitha vendet dhe sektorët për të garantuar shërbime shëndetësore cilësore, mbrojtje financiare dhe mirëqenie për të gjithë, në të gjitha moshat, pa përjashtim. OZHQ 3, që fokusohet tek shëndeti, synon “sigurimin e jetës së shëndetshme dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat”. Sipas të dhënave të fundit të OBSH-së për Shqipërinë (2024 - 2025), mbrojtja financiare ende është e dobët në krahasim me standardet evropiane dhe qytetarët akoma përballen me një barrë të madhe financiare për shërbimet shëndetësore.

Në vitin 2024, Shqipëria është renditur në krye të vendeve evropiane për përqindjen më të madhe të shpenzimeve shëndetësore që paguhen nga vetë qytetarët (out-of-pocket), rreth 59.7% të totalit të kostove shëndetësore, kryesisht për barna. OBSH ka rekomanduar në këtë drejtim që shpenzimet publike për shëndetësinë të rriten në të paktën 4.5% të PBB-së, pasi shifra aktuale është rreth 3.3% të PBB-së, nuk është e mjaftueshme për të ndikuar në uljen e shpenzimeve shëndetësore të mbuluara nga vet qytetarët. Megjithatë, këto të dhëna tregojnë se, edhe pse ka pasur përpjekje për të përmirësuar financimin dhe për të zgjeruar mbrojtjen financiare, qytetarët vazhdojnë të jenë subjekt i kosto të larta për barna dhe shërbime spitalore, ndërsa buxhetet publike të shëndetësisë nuk janë ende të mjaftueshme për të lehtësuar barrën financiare ndaj familjeve.

## II. 2. 2 MBROJTJA SOCIALE

Vizioni i Ministrisë në fushën e mbrojtjes sociale shprehet përmes një sërë dokumentesh strategjike, si Strategjia për Barazinë Gjinore, Plani Kombëtar për Barazi, Agjenda për të Drejtat e Fëmijëve, Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara. Këto dokumente synojnë një qeverisje gjithëpërfshirëse dhe efektive, duke garantuar mbrojtje dhe mbështetje për të gjitha shtresat e marginalizuara të shoqërisë. Përmes hartimit dhe zbatimit të tyre, qeveria synon të harmonizojë politikat kombëtare me Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ) deri në vitin 2030, si për shembull:

- **OZHQ 2.** Zero uri

<sup>32</sup> [https://kont.zsf.jcu.cz/pdfs/knt/2024/04/09.pdf?utm\\_source=chatgpt.com](https://kont.zsf.jcu.cz/pdfs/knt/2024/04/09.pdf?utm_source=chatgpt.com)

<sup>33</sup> [https://albania.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/albania\\_demographic\\_health\\_challenges\\_report\\_2020\\_english\\_version.pdf?utm\\_source=chatgpt.com](https://albania.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/albania_demographic_health_challenges_report_2020_english_version.pdf?utm_source=chatgpt.com)

<sup>34</sup> Shih shënim në fund të faqes nr. 4

<sup>35</sup> [https://www.co-plan.org/wp-content/uploads/2023/03/6.-Raport-mbi-reformimin-e-sistemit-spitalor-ne-Republiken-e-Shqiperise-Rustem-Celami.pdf?utm\\_source=chatgpt.com](https://www.co-plan.org/wp-content/uploads/2023/03/6.-Raport-mbi-reformimin-e-sistemit-spitalor-ne-Republiken-e-Shqiperise-Rustem-Celami.pdf?utm_source=chatgpt.com)

- **OZHQ 3.** Shëndet i mirë dhe mirëqenie
- **OZHQ 4.** Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës.
  - Deri në vitin 2030, sigurohuni që të gjitha vajzat dhe djemtë të kryejnë arsimin fillor dhe të mesëm falas, të drejtë dhe cilësor, duke çuar në rezultate të rëndësishme dhe të dobishme të të nxënit.
  - Deri në vitin 2030, sigurohuni që të gjitha vajzat dhe djemtë të kenë qasje në zhvillimin cilësor të fëmijërisë së hershme, kujdesin dhe arsimin parafillor në mënyrë që ato të jenë të gatshme për arsimin fillor.
- **OZHQ 5.** Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave
  - 5.2 Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj të gjitha grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe llojet e tjera të shfrytëzimit seksual; dhe
  - 5.3 Eliminimi i të gjitha praktikave të dëmshme, të tilla si fëmija, martesat e hershme dhe e detyruar dhe gjymtimi i organeve gjenitale të grave.

**OZHQ 8.** Promovimi i rritjes së qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike, punësimi i plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.

- 8.7 Merrni masa të menjëhershme dhe të dobishme për të çrrënjësuar punën e detyruar, për t'i dhënë fund skllavërisë moderne dhe trafikimit njerëzor dhe për të siguruar ndalimin dhe eliminimin e formave më të padenja të punës së fëmijëve, duke përfshirë rekrutimin dhe përdorimin e fëmijëve ushtarë, dhe deri në vitin 2025 të përfundojë puna e fëmijëve në të gjitha format e saj.

**OZHQ 10.** Ulja e pabarazisë brenda dhe midis vendeve

- 10.6 Sigurimi i përfaqësimit dhe zërit të zgjeruar për vendet në zhvillim në vendimmarrjen në institucionet globale ekonomike dhe financiare, në mënyrë që të ofrojnë institucione më efektive, të besueshme, të përgjegjshme dhe legjitime.
- 10.7 Lehtësimi i migrimit dhe lëvizshmërisë së rregullt, të sigurt dhe të përgjegjshme të njerëzve, duke përfshirë zbatimin e politikave të planifikuara dhe të menaxhuara mirë të migracionit. *OZHQ 16. Paqe, drejtësi dhe institucione të forta.*

**OZHQ 16.** Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve të dobishme, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

- 16.2 Të përfundojë abuzimi, shfrytëzimi, trafikimi dhe të gjitha format e dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve.
- 16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet.
- 16.10 Të sigurojë aksesin e publikut në informacion dhe të mbrojë liritë themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

### **Fushat në të cilat shtrihet veprimtaria e ministrisë sa i takon mbrojtjes sociale**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ushtron veprimtarinë e saj në fushën e mbrojtjes sociale në disa drejtime kryesore, të cilat kanë për qëllim garantimin e mbrojtjes, përkujdesjes dhe integritit të grupeve më vulnerabël të shoqërisë:

- Mbrojtja e fëmijëve – përmes politikave dhe shërbimeve që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, parandalimin e abuzimit dhe shfrytëzimit, si dhe mbështetjen për fëmijët në nevojë.
- Barazia gjinore dhe të drejtat e grave – përmes strategjive dhe planeve kombëtare që synojnë promovimin e barazisë, parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri.
- Personat me aftësi të kufizuara – duke ofruar shërbime sociale, programe integrimi, akses në arsim, punësim dhe përkujdesje të dedikuara, në përputhje me konventat ndërkombëtare.
- Ndihma ekonomike – administrimi i ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera për mbrojtjen sociale të individëve dhe familjeve në nevojë.
- Shërbimet sociale në komunitet – zhvillimi i shërbimeve sociale alternative, përkujdesja afatgjatë për të moshuarit, ofrimi i strehimit social dhe mbështetja për individët në situatë vulnerabiliteti.
- Mbrojtja e të miturve nga abuzimi me substanca – politika për parandalimin e përdorimit të alkoolit, drogave dhe substancave të tjera të fëmijët dhe të rinjtë.
- Integrimi i grupeve të marginalizuara – mbështetje për romët, egjiptianët, migrantët, viktimat e trafikimit dhe kategori të tjera të riskuara për të siguruar akses të barabartë në shërbime.

Nëpërmjet këtyre fushave, MSHMS synon të ndërtojë një sistem gjithëpërfshirës mbrojtjeje sociale që promovon barazi, solidaritet dhe mirëqenie për të gjitha shtresat e shoqërisë.

### **Auditimet e performancës në aspektet e mbrojtjes sociale**

Auditimet e performancës të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në fushën e mbrojtjes sociale janë fokusuar në vlerësimin e mënyrës se si politikat, programet dhe shërbimet sociale arrijnë të përmbushin qëllimin e tyre për të mbështetur shtresat më vulnerabël të shoqërisë. Në këtë kuadër, KLSH ka audituar skemën e ndihmës ekonomike, duke evidentuar problematika të tilla si shpërndarja e pabarabartë e fondeve, përjashtimi i familjeve në nevojë për shkak të kriterëve jo të përshtatshme, si dhe mungesa e monitorimit efektiv të përfituesve. Një tjetër auditim ka pasur në fokus shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, ku u konstatua mungesa e infrastrukturës së përshtatshme, akses i kufizuar në shërbime dhe vonesa në përfitimin e pagesave përkatëse. Po ashtu, auditimi mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ka nxjerrë në pah se, strukturat përgjegjëse shpesh nuk arrijnë të ofrojnë mbrojtje të plotë nga abuzimi, shfrytëzimi dhe braktisja, ndërkohë që shërbimet komunitare për fëmijët janë të fragmentuara dhe të pamjaftueshme. Auditimet kanë trajtuar edhe tematika të barazisë gjinore dhe dhunës në familje, duke theksuar mungesën e kapaciteteve profesionale dhe koordinimit ndër-institucional për ofrimin e shërbimeve mbështetëse. Përmes këtyre auditimeve, KLSH ka dhënë rekomandime për forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e transparencës dhe eficiencës në përdorimin e

fondeve publike, si dhe për zhvillimin e shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse që garantojnë akses dhe mbrojtje të barabartë për të gjitha grupet në nevojë.

### **Qëndrimi ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes sociale**

Qëndrimi ndërkombëtar për Shqipërinë në fushën e mbrojtjes sociale është se vendi ka bërë hapa të dukshëm përpara në krijimin e një kuadri strategjik dhe ligjor, por mbetet ende përballë sfidave të mëdha në drejtim të eficiencës, gjithëpërfshirjes dhe qëndrueshmërisë financiare të sistemit. Komisioni Evropian në Raportin e Progresit 2024 thekson se, miratimi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024 - 2030 është një hap pozitiv, por zbatimi praktik mbetet i ngadalshëm dhe kapacitetet në nivel vendor janë ende të kufizuara. ILO<sup>36</sup> dhe Banka Botërore vënë në dukje se, shpenzimet për mbrojtjen sociale në Shqipëri janë më të ulëta krahasuar me mesataren e rajonit dhe të BE-së, ndërkohë që varësia e lartë nga ndihma ekonomike nuk shoqërohet gjithmonë me shërbime mbështetëse që të ndihmojnë integrimin afatgjatë të përfituesve. UNICEF dhe UNDP theksojnë se, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, komunitetet rom dhe egjiptian, si dhe gratë që përballen me dhunë apo pabarazi, mbeten grupet më të rrezikuara nga përjashtimi social dhe që kërkojnë politika më të targetuara. Në këtë kuptim, këndvështrimi ndërkombëtar është se Shqipëria duhet të forcojë sistemin e mbrojtjes sociale, duke e bërë më transparent, më gjithëpërfshirës dhe më të qëndrueshëm financiarisht, në mënyrë që të garantojë një nivel bazë mbrojtjeje për të gjithë qytetarët dhe të sigurojë përmbushjen e parimit të “mos lënies askujt pas” në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

### **Fushat me risk**

Në kuadër të mbrojtjes sociale, fushat me risk lidhen kryesisht me grupet më vulnerabël të shoqërisë dhe me funksionimin e mekanizmave shtetërorë për t'i mbrojtur ata. Bazuar në analizat e KLSH-së, raportet e OBSH, UNDP, UNICEF dhe dokumentet strategjike të MSHMS, disa nga fushat kryesore të riskut janë:

1. Ndihma ekonomike dhe skemat e mbështetjes financiare
  - Rreziku i përjashtimit të familjeve të varfra për shkak të kriterëve të ngurta ose procedurave jo transparente.
  - Shpërndarja e pabarabartë e fondeve sipas rajoneve.
  - Varësia e lartë e familjeve nga pagesat direkte pa shoqëruar me shërbime sociale plotësuese.
2. Personat me aftësi të kufizuara (PAK)
  - Mungesa e aksesit fizik në shërbimet publike dhe sociale.
  - Vonesat në përfitimin e pagesave dhe mbështetjeje financiare.
  - Mungesa e shërbimeve të personalizuar për integrimin në arsim, punësim dhe jetën komunitare.
3. Mbrojtja e fëmijëve
  - Risk i lartë për fëmijët në situatë abuzimi, braktisjeje ose trafikimi.
  - Shërbime të fragmentuara komunitare dhe mungesë e strukturave rezidenciale cilësore.
  - Vështirësi në zbatimin e masave të alternativave ndaj institucionalizimit.
4. Barazia gjinore dhe dhuna në familje
  - Rritja e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe mungesa e mekanizmave të fortë

---

<sup>36</sup> International Labour Organisation – Organizata Botërore e Punës

- për parandalim dhe rehabilitim.
  - Vonesat në sigurimin e strehimit dhe shërbimeve për gratë dhe fëmijët viktime të dhunës.
5. Mbrojtja e të moshuarve
- Sistemi i pensioneve mbetet i brishtë, me rrezik për qëndrueshmërinë financiare afatgjatë.
  - Mungesë shërbimesh komunitare dhe rezidenciale për të moshuarit pa përkujdesje familjare.
6. Grupet e marginalizuara
- Komunitetet rom dhe egjiptian, migrantët, viktimat e trafikimit, të pastrehët shpesh përballen me diskriminim, mungesë aksesit në shërbime dhe mbështetje të fragmentuar.
7. Sistemi i shërbimeve sociale
- Kapaciteti i kufizuar institucional dhe burime njerëzore të pamjaftueshme.
  - Mungesë monitorimi dhe vlerësimi të politikave për matjen e impaktit real.
  - Përdorim jo eficient i fondeve dhe rrezik korrupsioni në shpërndarjen e tyre.

## II. 3 Mbledhja e të ardhurave

### Vizioni strategjik

Këshilli i Ministrave, çdo vit, miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal (KMF) për periudhën afatmesme 3-vjeçare. Ky dokument është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar Buxhetor dhe përgatitet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Nëpërmjet KMF, qeveria projektton pritshmërinë makroekonomike në harkun kohor afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. KMF përmban edhe parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskal, të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë. Në kuadrin Makroekonomik e Fiskal të miratuar për periudhën 2025-2027 me VKM nr. 399 datë 19.06.2024, të ndryshuar dhe kuadrin e miratuar për periudhën 2026-2028 me VKM nr. 83 datë 05.02.2025, synohet konsolidimi i vijueshëm fiskal me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse.

Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe plani i veprimit 2023-2026, në shtyllën 3 “Menaxhimi dhe mobilizimi i të ardhurave” vë theksin në komponentë të ndryshëm, si miratimi formal i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, rritja e kapaciteteve institucionale për të analizuar dhe zhvilluar politikat tatimore, zhvillimi dhe zbatimi i iniciativave për të reduktuar hendekun e pajtueshmërisë me TVSH-në, zhvillimi dhe zbatimi i një qasjeje të integruar për të reduktuar punën e padeklaruar, sigurimi i taksimit të çdo pasurie të pajustificuar brenda dhe jashtë vendit, përmirësimi i kadastrës fiskale dhe sistemit të mbledhjes së taksës së pasurisë, modernizimi i proceseve të biznesit dhe menaxhimit të riskut të Administratës Doganore, zhvillimi i kuadrit të integritetit dhe luftës kundër informalitetit dhe korrupsioni, me fokus kryesor rritjen dhe miradministrimin e të ardhurave buxhetore.

Sistemi i mbledhjes së të hyrave në shkallë sistemi ka efekt të rëndësishëm në aspektin makroekonomik dhe stabilitetin financiar të vendit. Ndryshimet e shpeshta strukturore në kuadrin ligjor dhe atë strukturor të administratave përgjegjëse, krijojnë risk për keq-aplikim

të dispozitave dhe krijimin e presionit fiskal jo proporcional tek taksapaguesit, të cilët operojnë në vend. Problematikat evidentohen edhe në reagimet dhe debatet konsistente publike nga shoqatat e biznesit lidhur me keqfunksionimin fiskal dhe miradministrimin e të hyrave. Vendi ende nuk ka arritur të ngrejë një sistem të thjeshtë dhe të drejtë taksimi për të ndihmuar klimën e të bërit biznes dhe rritur përmes saj të hyrat tatimore. Ndërkohë niveli i lartë i informalitetit sipas perceptimit publik, por dhe raporteve të organizmave ndërkombëtarë për sistemin e taksave në Shqipëri, ngre sfida të vazhdueshme për institucionet përgjegjëse dhe kërkon analiza të thelluara.

Puna audituese në sektorin tatimor, mbledhjen e të ardhurave, është përqëndruar kryesisht në fushat për të cilat KLSH ka vlerësuar një nivel të lartë risku. Gjatë vitit 2024, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe jo vetëm, lidhen me administrimin e të ardhurave: menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keq administrimin e pronës shtetërore ndjekur nga paligjshmëritë procedurale dhe inefficencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe shkeljet në zbatimin e legjislacionit fiskal. Në fushën e të ardhurave publike, auditimet kanë zbuluar probleme me mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave doganore dhe tatimore dhe mos rikuperimin e borxhit doganor dhe tatimor. Ndërkohë, ka vijuar të konstatohen klasifikime të gabuara tarifore dhe mospërdorim i masave ndëshkuese. Në vitin 2024, janë evidentuar mangësi në aktivitetin kontrollues me ndikim negativ në të ardhurat tatimore dhe doganore me vlerë 1,757,548 mijë lekë, ku vetëm në Degën Doganore Tiranë, në vlerën 889,636 mijë lekë, ose 51%.

### **II. 3. 1 MBI ADMINISTRIMIN TATIMOR**

Ndryshimet e shpeshta në legjislacionin fiskal konsiderohen me risk pasi sipas auditimeve të KLSH, janë miratuar tre ligje tatimore me efekte në të ardhurat buxhetore në muajin dhjetor 2023, jashtë afatit të përcaktuar në ligjin organik të buxhetit për t'u miratuar, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal. Rritja e të ardhurave nga TVSH nuk shoqërohet me rritjen e shumave për rimbursimin e saj, duke rezultuar në vijimësi me tejkalim të këtij treguesi me ndikim në uljen e të ardhurave në dispozicion të buxhetit të shtetit për këtë lloj tatimi. Sipas raportit të performancës së KLSH për vitin 2024, në Administratën Tatimore (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) u konstatuan probleme në mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe administrimin e detyrimeve. Edhe pse DPT ka bërë përmirësime në disa drejtime, KLSH konstatoi devijime materiale që sollën opinion të kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së saj, bazuar në: Një stok borxhi tatimor të rritur ku, në fund të vitit 2023, totali i detyrimeve tatimore të prapambetura arriti në rreth 155.2 miliard lekë që i përkasin mbi 181 mijë tatimpaguesve debitorë. Vetëm gjatë vitit 2023, stoku i detyrimeve u shtua edhe me 40 miliard lekë. Për më tepër, në evidencat e DPT ekzistojnë rreth 2.35 miliard detyrime tatimore jashtë sistemit elektronik C@TS. Për këtë, KLSH rekomandoi që DPT të ndërmarrë dhe intensifikojë masa shtrënguese të parashikuara si: bllokime asetesh, ndalim aktiviteti etj., si dhe integrimin e plotë të të gjitha detyrimeve në sistemin qendror, për një paraqitje dhe monitorim të plotë. Sa i takon rregullshmërisë së kontrolleve tatimore, si një formë e monitorimit dhe zbatimit të ligjshmërisë fiskale, u konstatua mosrealizimi i plotë i planit të kontrolleve tatimore, ku sipas të dhënave të DPT, nga 2982 kontrolle tatimore të planifikuara për vitin 2024, 109 kontrolle (rreth 4%) nuk u iniciuan fare. Kjo situatë vjen si rrjedhojë e mungesës së koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale Tatimore

që kryejnë kontrollet në terren. Gjithashtu, nga auditimi i funksionit të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren u konstatua se nuk ka një rakordim sistematik me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut mbi kontrollet e kryera dhe rezultatet e planeve operacionale. Në përgjithësi, rekomandimet e KLSH-së për administratën tatimore synojnë rritjen e eficiencës së mbledhjes së të ardhurave, zbatimi i të cilave do të ndihmojë në uljen e evazionit, arkëtimin më të mirë të detyrimeve, rritjen e transparencës ndaj biznesit. Po ashtu, KLSH sugjeroi vazhdimin e digjitalizimit të shërbimeve dhe mbikëqyrjes tatimore, me qëllim uljen e kontaktit të drejtpërdrejtë mes inspektorit dhe tatimpaguesit, duke minimizuar kështu mundësitë e korrupsionit. Pavarësisht veprimeve të ndërmarra, sistemi tatimor shfaq ende problematika mjaft të ndjeshme në arritjen e objektivave të caktuara, ndër të cilat fushat me risk të lartë dhe që kërkohet analizë e thelluar, përmendim:

- Ka pasur vonesa të konsiderueshme në rimbursimin e TVSH-së dhe janë akumuluar detyrime të prapambetura tatimore;
- Zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të menaxhimit të riskut të përmbushjes dhe kryerja e kontroleve ka marrë shumë kohë dhe kërkohet rritje e përpjekjeve për zbatim;
- Roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) duhet të forcohet më tej në mbledhjen e borxhit tatimor,
- Niveli i rritjes së informalitetit megjithë masat e marra në raste fushatash dhe nuk është ngritur sistem i qëndrueshëm e ndjekjen e këtij fenomeni vazhdimisht e jo me afate periodike,
- Lëvizjet në administratën tatimore dhe vendimet gjyqësore për rikthim në punë të pa zbatuara.

### **II. 3. 2 MBI ADMINISTRIMIN DOGANOR**

Nga auditimi mbi rregullshmërinë e aktivitetit të institucioneve të administrimit të të ardhurave fiskale u konstatua se: Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave rezultuan devijime nga kuadri ligjor në veprimtarinë doganore gjatë vitit 2023, të cilat u vlerësuan si materiale, megjithëse jo të përhapura. Për këtë arsye, KLSH dha Opinion të kualifikuar, duke tërhequr vëmendjen në çështjet e mungesës së përfshirjes në planifikimin e të ardhurave të degëve doganore. U konstatuan dobësi në funksionimin e kontroleve kundër kontrabandës, ku nga Drejtoria përkatëse, disa kontrole nuk finalizoheshin me masat e duhura, edhe në rastet kur zbuloheshin detyrime doganore të papaguara (shmangie taksash), autoritetet doganore nuk vendosnin gjobën e dyfishtë të detyrimit dhe nuk i klasifikonin shkeljet si “kundërvajtje doganore në neglizhencë”. Një tjetër fenomen, me ndikim në të ardhurat doganore të mbledhura, është ai i shkeljeve të rregullave për klasifikimin tarifor, vlerësimin doganor dhe llogaritjen e detyrimeve doganore. Praktikrat përfshijnë trajtim të padrejtë të çmimeve të mallrave të importuara, përdorim të pjesshëm ose selektiv të metodës së transaksionit, keqklasifikim të produkteve, si dhe shmangie nga pagesa e taksave dhe akcizave. Stoku i borxhit doganor, më 31.12.2023, rezultoi 47.6 miliard lekë në 4495 subjekte debitore. Ndërkohë, rikuperimi i borxhit doganor është në nivele të papranueshme, me vetëm 1.2% të stokut gjatë vitit 2023, çka tregon për mungesë kapacitetesh zbatuese dhe kontrolluese. Për sa më sipër, KLSH rekomandoi përmirësimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e riskut, koordinim më të mirë midis strukturave të planifikimit dhe atyre të kontrollit brenda administratës doganore, në mënyrë që planet e të ardhurave të jenë realiste dhe kontrollet të jenë të synuara e efektive dhe të kontribuojnë

në uljen e hapësirave për kontrabandë e abuzime. Nga auditimet në DPD dhe degë doganore problematikat kryesore dhe fushat me risk përfshijnë:

-Degët doganore nuk përfshihen në procesin e planifikimit të të ardhurave, por plani sipas çdo muaji përcillet nga DPD për zbatim;

-Stoku i detyrimeve të papaguara rritet me një ritëm më të lartë se sa pakësohet (mblidhet) gjatë procedurës së lëshimit të Autorizimeve të Përfshimit të TVSH-së, për disa operatorë ekonomikë të autorizuar më parë, vlerat në planet e investimit nuk arrijnë vlerën e parashikuar prej 500 milionë lekë me pasoja në mos pagesën e detyrimeve të TVSH-së në import dhe shmangien e detyrimeve doganore të TVSH-së.

-Janë deklaruar mallra me qëllim përjashtimin nga detyrimet doganore të TVSH-së, ku nuk janë kryer verifikime konkrete në ambientet e subjekteve deklarues, me qëllim evidentimin e përputhshmërisë faktike të gjendjes fizike të mallrave të përjashtuara, sipas autorizimeve respektive në funksion të kryerjes së investimit.

-Konstatohet mungesë menaxhimi me efikasitet dhe efikasitet i procedurave të përcaktuara nga legjislacioni për akcizat, mungesë planifikimi, miratimi e ushtrimi të kontroleve në mënyrë uniforme për gjatë gjithë muajve të vitit dhe mos dokumentim i relacioneve shpjeguese mbi programet e kontrollit për vitin.

-Janë konstatuar raste të regjimeve doganore të tipit RLP me pasoje shkelje të afateve ri eksportuese dhe autorizuese të shtyrjeve të afateve të veprimtarisë së këtyre aktiviteteve. Janë konstatuar vendime administrative për shkelje në fushën e akcizës, për të cilat janë vendosur masa konstatuese nga struktura kontrolluese të DPD-së, por për të cilat nuk është propozuar masë për konfiskimin e mallit objekt shkelje doganore dhe më pas riblerjen e tij para hedhjes dhe çlirimit të mallit. Janë konstatuar marrje të vendimeve në mosrespektim të legjislacionit doganor në fuqi, që lidhen me mosrespektim të afatit kohor për regjime doganore të tipit RLP në shumën totale.

-Mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore, të vlerësimit doganor të mallrave dhe shpenzimeve të transportit në import, klasifikime tarifore jo në përputhje me përcaktimet e Nomenklaturës së Mallrave në Republikën e Shqipërisë (RSH), deklarime doganore me pasoje mos pagesën e detyrimeve të akcizës.

### **II. 3. 3 MBI TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE**

Një tjetër fushë problematike e identifikuar është menaxhimi i të ardhurave nga shërbimet publike dhe burimet e veta, veçanërisht në njësitë vendore. Në auditimet e disa bashkive, janë konstatuar mospërputhje midis të ardhurave të raportuara dhe atyre të arkëtuara realisht, mungesë rakordimi me bankat apo me regjistrat e pagesave. Në disa raste, të ardhurat nga taksat vendore nuk ishin regjistruar në kohë ose ishin përdorur për qëllime të ndryshme nga destinacioni ligjor. Mungesa e menaxhimit të duhur të aseteve publike është një tjetër fenomen që përbën rrezik të drejtpërdrejtë për interesin ekonomik të shtetit. Siç ka rezultuar nga auditimet e KLSH të kryer në vitin 2024 në disa bashki, borxhi tatimor nga mos arkëtimi i taksave vendore është i lartë dhe është një fushë me risk të lartë, dhe që ka ndikuar direkt në pakësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në komunitetin e tyre. Konstatohet nevoja për të evidentuar ato çështje që kërkojnë analizë në fushën menaxheriale, mangësitë organizative e administrative dhe mungesën e përdorimit me efikasitet të penalteteve e masave të përshkallëzuara shtrënguese, si dhe niveli i informalitetit nëpërmjet veprimeve të pezullimit (formal) të aktiviteteve, duke kaluar pasiv,

mungesën e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe elementë të tjerë administrativ vendor, etj.

### **Qëndrimi ose këndvështrimi ndërkombëtar**

Në Progres Raportin e fundit të Bashkimit European për vitin 2024 për Shqipërinë, bazuar në problematikat e konstatuara, megjithëse vlerësohen përpjekjet e bëra, rekomandohet që:

- Të rishikohet strategjia afatmesme e të ardhurave, duke përfshirë masa për rritjen e peshës specifike të të ardhurave buxhetore në raport me Produktin e Brendshëm Bruto, adoptim dhe sigurimin e zbatimit të kësaj strategjie.
- Adoptimin e strategjisë afatmesme të të ardhurave duke përfshirë veprime për rishikime dhe qasje në reduktimin e mëtejshëm të përjashtimeve tatimore dhe në të njëjtën kohë përshtatjen e normave të TVSH-së dhe akcizës me normat e acquis të BE. Kjo pas vlerësimit se, asnjë zhvillim ligjor shtesë drejt përafrimit me acquis e BE nuk mund të raportohet dhe përjashtimet nga taksat mbeten një shqetësim për mbledhjen e të ardhurave.
- Rritja e të ardhurave publike është thelbësore për ruajtjen e një pozicioni fiskal të qëndrueshëm.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, në Janar 2025 sipas raportit në vijim të Artikullit 4, ka raportuar në lidhje me mbledhjen e të ardhurave buxhetore duke cituar që:

- Administrimi i të ardhurave do të duhet të mbështetet nga një infrastrukturë e përmirësuar e IT-së, shfrytëzimi i të dhënave, personeli dhe kapaciteti për të rritur pajtueshmërinë, duke përfshirë sektorët e turizmit dhe ndërtimit, si dhe midis individëve me pasuri të lartë neto.
- Përpjekjet duhet të rifillojnë për të përmirësuar regjimin tatimor për profesionistët e vetëpunësuar, në lidhje me heqjen e normës zero të taksës mbi të ardhurat për bizneset e vogla.
- Puna bazë për futjen e një ligji të ri për taksën e pronës - duke përfshirë krijimin e kadastrës fiskale - duhet të përfundojë në kohën e duhur.
- Shqipëria ka raportin më të ulët të efikasitetit C në rajon. Rimbursimet tatimore vlerësohen në 4.8 përqind të PBB-së, nga të cilat 3.7 përqind lidhen me TVSH-në. Shumëllojshmëria e pragjeve, normave dhe përjashtimeve inkurajon deklarin e pamjaftueshëm dhe dobëson vetëzbatueshmërinë. Adresimi i këtyre mangësive jo vetëm që do të zgjeronte bazën tatimore, por edhe do të mbështeste administrimin e të ardhurave.

Raporti i të ardhurave tatimore ndaj PBB-së ka luhatur rreth 19 përqind të PBB-së, 3-5 pikë përqindjeje nën mesataren evropiane dhe vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor. Shqipëria ka një performancë më të dobët në krahasim me potencialin e saj të të ardhurave tatimore, i cili vlerësohet nga FMN në rreth 23 përqind të PBB-së. Me normat kryesore të taksave, përgjithësisht në përputhje me homologët, hendeku i performancës sugjeron mangësi të rëndësishme në bazën tatimore dhe përdorimin e rimbursimeve tatimore, si dhe mangësi në përputhshmëri.

### **Auditime të KLSH**

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar në vazhdimësi auditime pranë administratës tatimore dhe asaj doganore, kjo edhe në funksion të misionit të tij kushtetues dhe ligjor. Drejtoria e

Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si njësitë kryesore strukturore së bashku me njësitë e tyre të varësisë, janë audituar në vijimësi nga KLSH. Më lart, kemi trajtuar gjetjet dhe rekomandimet e kryera në auditimet në DPT tatime dhe në DP Dogana, Dega e Doganës Tiranë, etj, ku janë evidentuar në këtë manual fushat me risk të lartë dhe nevoja për analizë të thelluar për të përcaktuar tema auditimi që do rrisin produktivitetin e auditimeve të performancës. Kjo do të ndihmojë shumë audituesit e performancës në vlerësimin e çështjeve e problematikave që mendohet se mund të kryhet AP dhe do të rrisin kontributin e KLSH në përmirësimin e qeverisjes.

Në auditimet e kryera nga KLSH, gjatë vitit 2024, në DRT janë evidentuar parregullsi në zbatimin e legjislacionit tatimor në proceset e kontrollit, mbikëqyrjes nga zyra të tatimpaguesve, zbatim të procedurave administrative, me efekte financiare të konsiderueshme në të ardhurat tatimore. Në auditimin e përputhshmërisë, e zhvilluar në DPT gjatë vitit 2024, janë evidentuar mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore, moskryerjen e kontrolleve, procesin e rimbursimit të TVSH-së, në koordinimin midis DPT dhe drejtorive rajonale, etj.

Në auditimin e ushtruar në DPD, gjatë vitit 2024, janë evidentuar veprimtari administrative në mospërputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Disa nga fushat në të cilat janë evidentuar shkelje dhe paraqiten mangësi, janë vlerësimi doganor i mallrave, akcizës, mbikëqyrja e regjimeve doganore, procedurat e lëshimit të autorizimeve, ligjshmëria dhe rregullshmëria e vendimeve të nxjerra, të cilat kanë rezultuar të ardhura të munguara në vlera të konsiderueshme. Në auditimet e ushtruara në Degë Doganore, gjatë vitit 2024, janë evidentuar mangësi dhe parregullsi sa i përket, metodave të vlerësimit doganor për mallrat e importuar, keq klasifikim kodesh tarifore, keq aplikim i koeficienteve të shfrytëzimit të mallrave të hyra në Regjimin e Përpunimit Aktiv, mos ndjekja në vazhdimësi dhe kohën e duhur të regjimit sipas subjekteve, mbajtës të autorizimeve Regjimi i Përpunimit Aktiv, të cilat kanë derivuar me mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit.

## II. 4. INFRASTRUKTURA

### Vizioni strategjik

Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit ka qenë dhe vijon të jetë një nga prioritetet strategjike të Qeverisë Shqiptare. Në vizionin e Qeverisë, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, synohet të krijohen kushte të favorshme për nxitjen e sektorëve të tjerë ekonomikë (veçanërisht turizmit), të përmirësohet lëvizja e mallrave dhe pasagjerëve në tregjet rajonale dhe evropiane, si dhe të rritet ndjeshëm zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i vendit, duke plotësuar kështu edhe angazhimet e vendit tonë në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare.<sup>37</sup> Qëllimi strategjik është: *“Zhvillimi i infrastrukturës në mënyrë të qëndrueshme, të zgjuar, si edhe të integruar me rrjetet evropiane dhe rajonale, bazuar në shfrytëzimin e gjelbër të burimeve, si edhe duke siguruar nxitje të zhvillimit ekonomik dhe shërbime me cilësi për qytetarët.”*<sup>38</sup> Aktualisht nuk ka një Strategji Kombëtare të Transportit të hartuar, megjithatë referuar Programit të Qeverisë 2021-2025 dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030,<sup>39</sup> objektivat e përgjithshme për transportin listohen si më poshtë:

<sup>37</sup> Vendim nr. 88, SKZHIE 2022-2030, datë 22.2.2023, fq. 97

<sup>38</sup> Vendim nr. 88, SKZHIE 2022-2030, datë 22.2.2023, fq. 97

<sup>39</sup> Vendim nr. 88, SKZHIE 2022-2030, datë 22.2.2023: Kapitulli Infrastruktura e ndërlidhjeve: transporti dhe telekomunikacioni

### ***Transporti Ajror***

Portat e ajrit janë një tjetër mundësi për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit dhe turizmit në veçanti. Me të njëjtin ritëm, si në transportin detar, edhe në atë ajror, vijon implementimi i strategjisë për krijimin e një rrjeti aeroportesh që do të mbulojë operime të brendshme, rajonale dhe ndërkontinentale, për t'i dhënë turizmit shqiptar nxitjen e nevojshme për t'u shëndrruar në një shtyllë ekonomike të vendit, për të krijuar vende pune për qytetarët dhe për t'i dhënë komuniteteve lokale zhvillim ekonomik më të lartë. Qëllimi i politikës 2023 për transportin ajror është: *“Krijimi i një tregu më konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara, përmes zhvillimit dhe ndërtimit të aeroporteve të reja, si dhe zbatimit dhe unifikimit të standardeve ndërkombëtare dhe BE-së për sigurinë në operim.”*<sup>40</sup>

### ***Transporti Detar***

Objektivi strategjik i qeverisë shqiptare për zhvillimin e transportit detar ka në fokus ridimensionimin e infrastrukturës portuale dhe të transportit detar përmes zgjerimit të zonave portuale, komplementimit me zona të zhvillimit ekonomik, zhvillimit dhe specializimit të porteve ekzistuese sipas sektorëve ekonomikë primarë ku operojnë, si dhe përmes shtimit të strukturave të specializuara për akomodim dhe ofrimin e shërbimeve për mjete lundruese turistike, të luksit, të transportit të mallrave apo pasagjerëve.

### ***Transporti Rrugor***

Në sektorin e infrastrukturës rrugore vijon implementimi i strategjisë për ndërtimin e një rrjeti efikas dhe eficient të transportit rrugor të disponueshëm dhe të aksesueshëm nga të gjithë qytetarët, i menaxhuar nga autoritete të besueshme, transparente, me performancën e duhur, dhe që siguron ndjeshëm mobilitetin, rritjen e cilësisë së jetesës dhe rritjen ekonomike. Qëllimi i Politikës 2030 për transportin rrugor është: *“Zhvillimi i sistemit kombëtar të transportit mbi bazën e një lëvizshmërie më të sigurt, më të zgjuar, më të gjelbër, elastike dhe konkurruese, të cilat sigurojnë një transport të qëndrueshëm, të ndërlidhur, ndërveprues dhe të integruar me rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë me sistemin Evropian të transportit”*<sup>41</sup>

### ***Transporti Hekurudhor***

Gjendja e transportit hekurudhor në Shqipëri ka vite që është në rënie. Sfidë kryesore vijon të mbetet reformimi i sistemit hekurudhor, që duhet të vazhdojë të thellohet për të krijuar një treg të hapur për investitorë të ndryshëm, si në aspektin e menaxhimit infrastrukturor, edhe në funksionimin e hekurudhës.<sup>42</sup> Qëllimi i Politikës 2030 për transportin hekurudhor është: *“Reformimi i sektorit hekurudhor për krijimin e mundësive reale të funksionimit të transportit hekurudhor për publikun, si edhe për krijimin e një tregu të hapur për investitorët publikë dhe privatë, duke e transformuar rrjetin hekurudhor shqiptar si një aktor funksional në korridoret e transportit të Evropës Jug-Lindore.”*<sup>43</sup>

---

<sup>40</sup> Vendim nr. 88, SKZHIE 2022-2030, datë 22.2.2023, fq. 102

<sup>41</sup> Vendim nr. 88, SKZHIE 2022-2030, datë 22.2.2023, fq. 99

<sup>42</sup> Vendim nr. 88, SKZHIE 2022-2030, datë 22.2.2023, fq. 99

<sup>43</sup> Vendim nr. 88, SKZHIE 2022-2030, datë 22.2.2023, fq. 100

## Lista unike e projekteve dhe vlerat indikative

Përmes VKM nr. 161, datë 20.03.2024 “Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2025–2027”, janë miratuar politikat prioritare të cilat janë kryer bazuar në:

- a. Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030,
- b. Kuadrin Strategjik (strategjitë sektoriale/ndërsektoriale).

Në total VKM-ja ka konkluduar<sup>44</sup> me një listë unike projektsh, duke identifikuar ndër të tjera emrin e projektit, sektorin<sup>45</sup>, vlerën indikative, institucionin përgjegjës dhe statusin e maturimit. Sipas listës unike janë:

- maturuar 51 projekte në vlerën indikative 4,517,982,508 euro,<sup>46</sup>
- pjesërisht të maturuar 53 projekte në vlerën indikative 7,816,623,380 euro,<sup>47</sup>
- të pamaturuar 33 projekte në vlerën indikative 2,073,648,036 euro.<sup>48</sup>

## Qëndrimi ose këndvështrimi ndërkombëtar

Referuar Progres-Raportit të KE për vitin 2024, situata lidhur me infrastrukturën reflektohet në kapitullin 14 të tij, si më poshtë vijon:

**Në aspektin e përgjithshëm:** Strategjia kombëtare e transportit dhe plani i saj i veprimit për 2021-2025 nuk janë miratuar ende. Për harmonizimin e politikës së transportit me detyrimet e shërbimit publik dhe *acquis-in* mbi kontratat e shërbimit publik, udhëzimet mbi shërbimet e transportit publik të pasagjerëve me rrugë dhe shërbimet e transportit publik të pasagjerëve me hekurudhë u miratuan në dhjetor 2023. Nevojiten më shumë përpjekje për të zbatuar plotësisht Direktivën e Sistemeve Inteligjente të Transportit (ITS), për të nxitur multimodalitetin dhe për të zbatuar ligjet përkatëse kombëtare në përputhje me planet e veprimit të Komunitetit të Transportit. Strategjia kombëtare e ITS për mënyrat hekurudhore dhe detare ende nuk është miratuar. Ndërtimi i qendrës së monitorimit të trafikut dhe instalimi i ITS për 200 km të rrjetit kryesor rrugor janë në proces dhe pritet të jenë funksionale në vitin 2024. Për aglomeratet më të mëdha të transportit, duhet të zhvillohen plane të lëvizshmërisë urbane të qëndrueshme që respektojnë standardet mjedisore dhe sociale duke ndjekur praktikën e BE-së.

Shqipëria vazhdoi të marrë pjesë aktive në punën e Komunitetit të Transportit (TCT), megjithatë shkalla e zbatimit të pesë planeve të veprimit të Traktatit të Komunitetit të Transportit dhe strategjisë së dedikuar për lëvizshmëri të zgjuar dhe të qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor mbetet e ngadaltë. Kapaciteti administrativ ende ka nevojë për forcim në të gjithë sektorin e transportit, veçanërisht në sektorin hekurudhor. Një plan veprimi pesëvjeçar është në vazhdim që nga marsi i vitit 2023 për të rritur kapacitetet në planifikimin dhe zbatimin e projekteve të infrastrukturës në sektorin hekurudhor. Fondet e

<sup>44</sup> Duhet të mbajmë në konsideratë që kjo listë ka ndryshuar nga lista fillestare, nëpërmjet VKM-së nr.533, datë 12.8.2024 që ka ndryshuar VKM Nr.161, datë 20.3.2024.

<sup>45</sup> Projektet e listës unike klasifikohen në një nga gjatë sektorët ekonomikë si: sektori digjital, zhvillimi ekonomik, energjia, mjedisi, social ose transporti.

<sup>46</sup> Projekt i maturuar konsiderohet projekti për të cilin është kryer studimi i fisibilitetit (ose studime analoge në varësi të tipologjisë së projektit) dhe është konsideruar fisibel ose kur projekti është në fazë të avancuar të përpilimit të dokumenteve teknike.

<sup>47</sup> Konsiderohet projekti për të cilin është iniciuar studimi i fisibilitetit, ose kur projekti ka iniciuar një pjesë të dokumenteve teknike

<sup>48</sup> Konsiderohet projekti për të cilin është iniciuar studimi i fisibilitetit, ose kur projekti ka iniciuar një pjesë të dokumenteve teknike

disponueshme për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore mbeten të pamjaftueshme, duke rezultuar në përkeqësim të vazhdueshëm të kushteve të infrastrukturës. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të mbështetur planet e mirëmbajtjes së hekurudhave 2018-2022.

Në **transportin rrugor**, ende nevojiten përpjekje për t'u përafuar me *acquis*-in mbi sistemet elektronike të pagesës rrugore dhe zbatimin e tarifave rrugore, si dhe mbi rregullat sociale dhe të tregut në transportin rrugor. Siguria rrugore mbetet një shqetësim serioz me viktima mbi mesataren e BE-së, dhe duhet të adresohen mospërputhjet midis statistikave kombëtare dhe vlerësimeve më të larta të OBSH-së. Shqipëria duhet të ndajë burime të mjaftueshme financiare për të krijuar një sistem të dhënash për aksidentet rrugore në përputhje me Bazën e të Dhënave CARE. Koordinimi i përmirësuar ndërinstytucional dhe krijimi i një agjencie për sigurinë e trafikut rrugor janë të nevojshme. Gjatë periudhës së raportimit, Shqipëria miratoi dy udhëzime për të përafuar më tej legjislacionin e saj mbi mallrat e rrezikshme. Vendi duhet të forcojë kapacitetin e saj të inspektimit mbi testet periodike të përshtatshmërisë rrugore. Puna e hartimit të strategjisë së sigurisë rrugore filloi në maj 2024 dhe vlerësohet të përfundojë në gjysmën e parë të vitit 2025. Shqipëria është ende pjesërisht e përafuar me direktivën mbi menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore.

Në **transportin hekurudhor**, u miratuan dy ligje mbi sigurinë dhe një mbi licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore. Për më tepër, bazuar në një ligj të miratuar më herët në vitin 2021, u krijua një autoritet për sigurinë hekurudhore. Procesi i rekrutimit të stafit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave, i cili është funksional që nga shtatori i vitit 2023, është duke vazhduar. Shqipëria ende duhet të sigurojë funksionimin e plotë të rrjetit hekurudhor dhe të operacionalizojë ndarjen e infrastrukturës nga funksionimi, në përputhje me Kodin Hekurudhor Shqiptar. Një ligj i vitit 2021, që adresonte këtë çështje, nuk u zbatua për shkak të burimeve të pakta financiare dhe njerëzore, duke e shtyrë Shqipërinë të hartojë një ligj të ri. Shqipëria duhet të ndjekë më tej përafrimin e plotë me rregullat e sigurisë dhe ndërveprimet hekurudhor të BE-së, duke përfshirë krijimin e një organi kombëtar hetimor funksional, regjistrin elektronik të mjeteve dhe sistemin e menaxhimit të aseteve të infrastrukturës hekurudhore (RIAMS). Për makinistët e trenave, një trajnim mbi transportin e mallrave të rrezikshme u zhvillua gjatë periudhës raportuese.

Në **transportin detar**, pas përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar ndjeshëm cilësinë e flotës me flamur shqiptar dhe për të ulur kështu shkallën e ndalimit të anijeve me flamur shqiptar, vendi arriti të hiqej nga pozicioni në listën e zezë të performancës së dobët të flamurit në listën gri të Memorandumit të Mirëkuptimit të Parisit mbi Kontrollin Shtetëror Portual (MoU i Parisit). Shqipëria ende nuk është përafuar plotësisht me *acquis*-in e BE-së për sistemin e monitorimit dhe informacionit të trafikut të anijeve (VTMIS), bazuar në kuadrin strategjik për zbatimin e ITS në rrjetin kryesor detar. Ende nuk ka pasur zhvillime të reja në lidhje me transportin detar të brendshëm, i cili është i kufizuar në dy liqene të përbashkëta me vendet fqinje dhe i rregulluar nga marrëveshje dypalëshe.

Në **aviacion**, gjatë periudhës së raportimit, u zhvillua një mision vlerësimi nëse vendi duhet të pranohet në fazën pasuese të Marrëveshjes së Zonës së Përbashkët Evropiane të

Aviacionit (ECAA). Edhe pse Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (CAA) ka një strukturë të re që nga janari 2023, me qëllim përmirësimin e funksionimit të tij, detyrat e mbikëqyrjes ende mbulohen nga stafi i kontraktuar nga jashtë. Gjatë periudhës së raportimit, CAA përgatiti dhe miratoi një plan trajnimi për të përmirësuar kapacitetet e saj.

Në *transportin multimodal*, Shqipëria ende nuk është përafruar me direktivën përkatëse të BE-së dhe ende nuk ka dhënë referenca për legjislacionin kombëtar që është përafruar me acquis të BE-së.

Nuk pati përparim në të *drejtat e pasagjerëve*. Legjislacioni për të drejtat ajrore të pasagjerëve është kryesisht i përafruar me legjislacionin e BE-së.

### **Auditime të KLSH**

Departamenti i Auditimit të Performancës ka kryer disa auditime performance, gjatë periudhës 2021-2025 në fushën e infrastrukturës, duke përcjellë mesazhet audituese, si më poshtë vijojnë:

Me Vendimin e Kryetarit nr. 176, datë 22.09.2022 është miratuar Raporti i Auditimit të Performancës me temë “Efektiviteti i Sinjalistikës Rrugore”. Mesazhi kryesor i këtij auditimi ishte: “Për periudhën 2018-2021, përmirësimi i sinjalistikës rrugore nuk është adresuar në mënyrë plotësisht efektive dhe eficiente. Strategjia për Sigurinë Rrugore 2011-2020, pavarësisht parashikimit për t’u përditësuar në intervale kohore (p.sh çdo vit), nuk është rishikuar asnjëherë. Plani i fundit i veprimit për këtë Strategji, i cili ka pasur në përbërje edhe aktivitete për përmirësimin e sinjalistikës rrugore, ka mbuluar periudhën deri në vitin 2015. Me gjithë zvogëlimin e numrit të vdekjeve në aksidentet rrugore në vitin 2020 krahasuar me vitin 2009 (viti referencës sipas strategjisë), numri i aksidenteve dhe numri i të plagosurve në aksidentet rrugore ka mbetur në të njëjtat nivele. Në vitet 2020-2021, megjithëse lëvizja ka qenë e kufizuar si rezultat i pandemisë Covid-19, numri i personave të plagosur rëndë në aksidente rrugore me faktor sinjalistikën rrugore, zinte rreth 10 % të totalit të të aksidentuarve rëndë. Edhe pse periudha në të cilin shtrihej strategjia e parë ka përfunduar, ende nuk është hartuar Strategjia e re për Sigurinë Rrugore. Nga auditimi nuk u siguruan evidenca mbi funksionimin e Komitetit Ndër-Ministror për Sigurinë Rrugore (KNSR), Sekretarisë Teknike të tij, apo Grupit Qendror të Drejtimit, që sipas kuartrit ligjor në fuqi, përbëjnë sistemin e menaxhimit të sigurisë rrugore në Shqipëri, pjesë e të cilës është edhe sinjalistika rrugore. Auditimi dhe inspektimi i sigurisë rrugore pothuajse nuk është kryer për periudhën në auditim, pasi në entet pronare të rrugëve dhe në MIE nuk janë ngritur strukturat përgjegjëse për to. Certifikimi i fundit i audituesve/inspektorëve të sigurisë rrugore është kryer në vitin 2017, e nuk ka vijuar më tej, pasi me ristrukturimin e ministrive të ndodhur në këtë vit, janë shkruar drejtoritë përgjegjëse. Për ata auditues të certifikuar (26 gjithsej) nuk ka vijuar trajnim periodik, duke mos siguruar aftësimin e plotë të tyre për kryerjen e auditimeve dhe inspektimeve të sigurisë rrugore. Vendi ynë ende nuk ka një Qendër të Kontrollit dhe Monitorimit të Trafikut, ndërsa 23 pajisjet e Sistemit të menaxhimit të trafikut në rrugët kombëtare, nuk funksionojnë. Sinjalistika rrugore është ngarkuar në mënyrë të pjesshme në sistemin GIS.

Me Vendimin e Kryetarit nr. 48, datë 29.03.2022 është miratuar Raporti i Auditimit të Performancës me temë “Të drejtat e pasagjerëve në transportin ajror”. Mesazhi kryesor i

këtij auditimi ishte: “Pavarësisht faktit se AAC vazhdimisht ka ndërmarrë masa në drejtim të garantimit të të drejtave të pasagjerëve, ky objektivi prioritar institucional, nuk është përmbushur plotësisht me efektivitet. AAC nuk ka hartuar një Strategji dhe si pasojë nuk ka përcaktuar objektiva konkrete dhe as plane veprimi, duke treguar deri diku, mungesë fokusi ndaj garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pasagjerëve që përdorin transportin ajror. Bazuar në interpretimin ligjor të dispozitave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, kjo veprimtari institucionale si pjesë përbërëse e misionit të AAC-së, mbart një rëndësi të veçantë, dhe kërkon një rol tërësisht aktiv të AAC-së kah efektivitetin të procesit që garanton të drejtat e pasagjerëve. Autoriteti i Aviacionit Civil nuk ka marrë masat e nevojshme me qëllim implementimin e kompensimeve për pasagjerët. Pavarësisht mandatit të të kufizuar të AAC-së, në implementimin e sanksioneve për operatorët ajror të huaj që operojnë në Republikën e Shqipërisë, ky institucion duhet të kishte ndërvepruar në mënyrë efektive me institucionet homologe, me qëllim garantimin e të drejtave të pasagjerëve. AAC nuk ka luajtur një rol proaktiv në mbikëqyrjen e kompanive ajrore dhe në informimin e qytetarëve. AAC nuk ka monitoruar statusin e ankesave dhe nuk ka kërkuar informacion periodik javor në kompanitë ajrore lidhur me zgjidhjen e dhënë dhe ankesat e drejtuara nga qytetarët. Nga 225 të anketuar që ju përgjigjën pyetësorit të shpërndarë për temën nën auditim, rezultoi se rreth 36 % e tyre nuk kishin informacion mbi të drejtat që gëzonin gjatë udhëtimit me transport ajror dhe 58.3 % nuk kishin informacion se AAC është institucioni shtetëror kompetent që garanton mbrojtjen e këtyre të drejtave.”.

Me Vendim e Kryetarit nr. 19, datë 16.02.2021 është miratuar Raporti i Auditimit të Performancës me temë “Menaxhimi i Transportit Hekurudhor në Shqipëri”. Mesazhi kryesor i këtij auditimi ishte: “Masat e marra nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Hekurudha Shqiptare SH.A, lidhur me menaxhimin e transportit hekurudhor në Shqipëri, nuk kanë qenë efektive. Ligji nr. 142/2016, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” nuk është zbatuar plotësisht. Arsyeja kryesore e mos zbatimit të këtij ligji është mos krijimi i Autoritetit Rregullator Hekurudhor, Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore, Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Autoritetit Licencues Hekurudhor. Për ngritjen e këtyre autoriteteve, MIE nuk ka hartuar kuadrin ligjor të posaçëm në përputhje me Ligjin nr. 142/2016, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Investimet në sektorin e transportit hekurudhor për periudhën 2016-2019 nuk kanë qenë të mjaftueshme duke mos realizuar disa prej objektivave kryesore të Strategjisë Sektoriale të Transportit 2016-2020. Treguesit kryesorë të performancës së sistemit hekurudhor janë në nivele shumë të ulta. Numri i pasagjerëve hekurudhorë për vitin 2019 ishte më i ulët i shënuar të paktën prej disa dekadash. Cilësia e shërbimit, siguria hekurudhore së bashku me infrastrukturën hekurudhore janë në gjendje të mjerueshme. Linjat hekurudhore sot janë tkurrur si kurrë më parë si rezultat i përkeqësimit dhe daljes jashtë funksionit të disa veprave kryesore të artit, si ura e Ishmit, ura e Rrogozhinës etj.”

### **Të tjera**

Strategjia Kombëtare për Transportin ka përfunduar në vitin 2020 dhe aktualisht nuk ka një strategji të re për vitet e ardhshme si bazë për zhvillimin dhe integrimin e mëtejshëm të rrjeteve të infrastrukturës shqiptare të transportit në ato evropiane. Strategjia e re e Transportit duhet të jetë një përditësim i strategjisë 2016-2020, duke marrë parasysh pikat

më të dobëta dhe më të forta të saj, si dhe prioritetet e reja të transportit, sipas Agjendës së Bashkëpunimit, Marrëveshjes së Gjelbër Europiane dhe Agjendës së Gjelbër, Strategjisë për zhvillim të qëndrueshëm dhe SMART të BE-së, Planit Ekonomik dhe Investues për Ballkanin Perëndimor, si dhe projekteve të reja prioritare.

## II. 5 MJEDISI

### Vizioni strategjik

Në Shqipëri, mbrojtja e mjedisit mbetet një përgjegjësi e përbashkët mes qeverisë, pushtetit vendor, sektorit privat dhe qytetarëve. Në dokumentet strategjike të viteve të fundit, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2021–2030 dhe Planeve Kombëtare (për fusha të ndryshme si ajri, mbetjet, biodiversiteti, burimet ujore, etj.), si dhe akteve ligjore e nënligjore, plotësohet detyrimi kushtetues ndaj shtetasve që gëzojnë të drejtën e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjik. Këto instrumente përcaktojnë objektivat kryesore të politikave mjedisore në përputhje me procesin e integritimit evropian dhe detyrimin kushtetues për të garantuar të drejtën e qytetarëve për një mjedis të qëndrueshëm.

Lidhur me **mbrojtjen e mjedisit**, Shqipëria e ka përcaktuar këtë sektor si një ndër prioritetet kryesore në SKZHI 2020–2030, duke synuar ruajtjen e natyrës, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe rritjen e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura. Vizioni kombëtar është në harmoni me objektivat globalë për biodiversitetin “Post 2020”, me synimin madhor që deri në vitin 2050 të arrihet jetesa në harmoni me natyrën. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë hapa për përafrimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së, përfshirë direktivat për Habitatet dhe Shpendët, si dhe është parashikuar rishikimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin deri në vitin 2030. Rritja e mbulimit të zonave të mbrojtura në 21% të territorit (2022), me synim 30% deri në vitin 2030, si dhe miratimi i Ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet” dhe krijimi i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, tregojnë përpjekjet drejt menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore. Gjithashtu, Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” dhe Ligji nr. 9587/2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 69/2024, forcojnë mbrojtjen ligjore të habitateve dhe llojeve të kërcënuara. Objektivat strategjikë deri në vitin 2030 përfshijnë transpozimin e plotë të legjislacionit të BE-së për natyrën, përmirësimin e statusit të ruajtjes së llojeve dhe habitateve të kërcënuara, krijimin e rrjetit ekologjik Natura 2000, futjen e biodiversitetit në programet arsimore dhe mbulimin e plotë të sipërfaqeve pyjore me plane mbarështimi. Këto masa synojnë, jo vetëm mbrojtjen e biodiversitetit, por edhe integrimin e zonave të mbrojtura në zhvillimin ekonomik, përmes turizmit të qëndrueshëm dhe paketave ekoturistike.<sup>49</sup>

Në fushën e **cilësisë së ajrit**, prioritet mbetet zbatimi i standardeve evropiane, konsolidimi i sistemit kombëtar të monitorimit, reformimi i sektorëve me peshë të rëndësishme në cilësinë e ajrit, reduktimi çdo vit i sasisë totale vjetore të substancave ozonholluese që importohen dhe hartimi i planeve të veprimit në nivel qendror dhe lokal. Këtë kuadër e mbështet Ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, si dhe VKM nr. 162/2020 “Për programet e pakësimit të shkarkimeve në ajër”. Sfida kryesore lidhet me

---

<sup>49</sup> Vendim nr. 88, datë 22.2.2023 për miratimin e “Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”, fq. 109-110.

përmirësimin e cilësisë urbane të ajrit dhe zbatimin e masave për uljen e ndotjes nga transporti dhe industria.<sup>50</sup>

Në lidhje me **ndryshimet klimatike**, Shqipëria ka miratuar një kuadër të plotë ligjor dhe strategjik për ndryshimet klimatike, përfshirë Ligjin nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (2019) dhe Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020–2030, të cilat përcaktojnë masa për uljen e emetimeve, sigurimi i mbrojtjes së vendit nga efektet e ndryshimeve klimatike, përmes masave përshatëse me fokus pjesën bregdetare deri në 2030. Për më tepër, Shqipëria ka përcaktuar një sërë ndërhyrjesh të rëndësishme për adresimin e ndryshimeve klimatike. Këto përfshijnë: plotësimin e legjislacionit dhe integrimin e çështjeve të klimës në të gjithë sektorët deri në vitin 2027; përfshirjen e masave zbutëse e përshatëse në buxhetimin publik dhe dokumentet strategjike kombëtare e vendore deri në vitin 2030; forcimin institucional dhe sigurimin e burimeve financiare e njerëzore për gjenerimin dhe shpërndarjen e të dhënave mbi klimën deri në 2029; ndërtimin e platformës kombëtare të informacionit për klimën deri në 2030; adoptimin e qasjeve të bazuara në ekosistem dhe natyrë deri në 2027; forcimin e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë me sisteme të paralajmërimit të hershëm deri në 2030; si dhe pilotimin e masave inovatore në fusha si menaxhimi i mbetjeve, mobiliteti, bujqësia, pylltaria, planifikimi urban, infrastruktura dhe energjia deri në vitin 2026.<sup>51</sup>

Në lidhje me **menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe ekonominë qarkulluese**, Shqipëria përmes Ligjit nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ka bërë hapa përpara në përafrimin e kuadrit ligjor me direktivat e Bashkimit Evropian dhe në ngritjen e kompanive që merren me grumbullimin dhe riciklimin e metaleve, plastikës, letrës, qelqit dhe disa rrymave të tjera të mbetjeve specifike si spitalore, bateri, vajra apo pajisje elektrike e elektronike. Megjithatë, sektori përballet me një sërë sfidash që lidhen me mbulimin ende të pjesshëm të shërbimit, infrastrukturën e dobët të grumbullimit dhe transportit, vend depozitimit jashtë standardeve, mungesën e ndarjes së mbetjeve në burim dhe nivelin e ulët të riciklimit. Kalimi drejt një ekonomie qarkulluese, siç parashikohet në SKZHI 2020–2030, lidhet drejtpërdrejt me përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të organizatës së Kombeve të Bashkuara (OZhQ 11, 12 dhe 14) dhe synon përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve. Për këtë arsye, objektivat prioritarë deri në vitin 2030 përfshijnë përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe zbatimin e kërkesave ligjore e planifikuese, harmonizimin e plotë të legjislacionit me BE-në, sigurimin e një financimi të qëndrueshëm dhe rritjen e ndërgjegjësimit e përfshirjes së publikut në mbrojtjen e mjedisit.

Në lidhje me **menaxhimin e integruar të ujërave**, Shqipëria konsiderohet si një vend me burime të pasura ujore, të cilat përfshijnë lumenj, liqene, akuifere dhe rezervuarë artificialë, por sfidat në përdorimin dhe administrimin e tyre mbeten të mëdha. Kuadri ligjor dhe institucional është ndërtuar në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe orientimin drejt

---

<sup>50</sup> Vendim nr. 88, datë 22.2.2023 për miratimin e “Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”, fq. 110-111.

<sup>51</sup> Vendim nr. 88, datë 22.2.2023 për miratimin e “Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”, fq. 143-144.

Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, duke e lidhur menaxhimin e ujit me energjinë, bujqësinë, turizmin dhe mbrojtjen nga katastrofat natyrore. Në këtë kuadër, qeveria ka ngritur Grupin për Menaxhimin e Integruar të Politikave (GMIP), i cili synon koordinimin ndërsektorial dhe orientimin e investimeve drejt një përdorimi më efikas dhe të qëndrueshëm të burimeve ujore.

Megjithëse 90% e ujit të pijshëm sigurohet nga burimet nëntokësore, furnizimi me ujë dhe kanalizime nuk është ende i plotë (77% dhe 51.9% mbulim për vitin 2021), ndërkohë që humbjet arrijnë në rreth 65% të prodhimit total. Në bujqësi, përdorimi i ujit për ujitje është i domosdoshëm, por kapaciteti i rezervuarëve është reduktuar me rreth 45% për shkak të erozionit dhe dëmtimeve teknike, duke rritur rrezikun për prodhimin bujqësor.

Në fushën e energjisë, varësia pothuajse ekskluzive nga hidrocentralet (97% e prodhimit) e bën vendin shumë të ndjeshëm ndaj kushteve hidrologjike, ndërsa industritë dhe aktivitetet minerare kanë krijuar ndotje të konsiderueshme të burimeve ujore.

Menaxhimi i ujit për mjedisin është po ashtu sfidues, pasi ligatinat dhe ekosistemet ujore ndodhen nën presion nga urbanizimi, ndotja dhe ndryshimet klimatike, duke rrezikuar biodiversitetin dhe habitatet e mbrojtura. Për këtë arsye, prioritetet deri në vitin 2030 lidhen me përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve, rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, garantimin e rrjedhjes ekologjike në trupat ujore, sigurimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit për energjinë dhe industrinë, si dhe reduktimin e ndotjes nga aktivitetet bujqësore dhe industriale.<sup>52</sup>

Në fushën e **kimikateve**, Shqipëria ka ngritur një kuadër ligjor dhe institucional që synon garantimin e përdorimit, ruajtjes dhe trajtimit të tyre në mënyrë të sigurt, për të shmangur ndikimet negative në shëndetin e njeriut dhe mjedis. Ligji nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve” përcakton rregullat për regjistrimin, autorizimin, kufizimin dhe kontrollin e kimikateve, në përputhje me standardet e BE-së. Ai kërkon që importuesit, prodhuesit dhe shpërndarësit të mbajnë përgjegjësi për menaxhimin e sigurt të kimikateve, si dhe parashikon detyrimin për etiketim, ruajtje të sigurtë dhe raportim tek autoritetet përkatëse.

Në lidhje me **zhurmat në mjedis**, kuadri ligjor është përcaktuar nga Ligji nr. 9774/2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i cili synon parandalimin dhe reduktimin e ndotjes akustike në zonat urbane dhe industriale. Ky ligj është i harmonizuar me Direktivën 2002/49/EC të BE-së për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis, duke kërkuar hartimin e hartave strategjike të zhurmës dhe planeve të veprimit për uljen e saj. Në këtë kuadër, është miratuar edhe Plani Kombëtar i Veprimit për Zhurmat, që përcakton masat konkrete për monitorim, vendosjen e kufijve ligjorë të niveleve të zhurmës dhe zbatimin e standardeve akustike në transport, ndërtim, shërbime dhe industri.

### **Qëndrimi ose këndvështrimi ndërkombëtar**

Sipas Raportit të Komisionit Evropian 2024, Shqipëria ka bërë disa hapa përpara, por mbetet në nivel përgatitjeje të kufizuar në përafrimin dhe zbatimin e *acquis* të BE-së për mjedisin dhe klimën. Raporti shfaq se, kuadri horizontal i legjislacionit, veçanërisht në lidhje me vlerësimet e ndikimit mjedisor dhe vlerësimet strategjike mjedisore, ka cilësi të ulët, rekomandimet rrallë zbatohen dhe pjesëmarrja e publikut është e dobët, ndërkohë që

---

<sup>52</sup> Vendim nr. 88, datë 22.2.2023 për miratimin e “Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”, fq. 105 – 107.

ndryshimet e fundit ligjore për zonat e mbrojtura janë miratuar pa konsultim të gjerë dhe kanë sjellë shqetësime për rrezikimin e vlerave ekologjike. Kapacitetet e kufizuara inspektuese, buxhetet e pamjaftueshme dhe mungesa e ekspertizës e dobësojnë zbatimin, ndërsa rastet e korrupsionit, si çështja e inceneratorit të Tiranës, tregojnë nevojën për forcim të integritetit institucional.

Në fushën e ajrit, raporti evidenton se, Shqipëria nuk ka bërë përparim të dukshëm, pasi strategjia kombëtare e vitit 2014 nuk është zbatuar dhe sistemi i monitorimit është i kufizuar me vetëm shtatë stacione jo funksionale. Edhe në menaxhimin e mbetjeve, legjislacioni mbetet vetëm pjesërisht i përafuar dhe politikat nuk arrijnë objektivat e hierarkisë së mbetjeve dhe riciklimit, ndërsa ndalimi i qeseve plastike nuk zbatohet në mënyrë të qëndrueshme.

Në fushën e ujërave, raporti shfaq se, Shqipëria ka ndërmarrë hapa pozitivë me miratimin e ligjit për burimet ujore dhe ligjit për mbrojtjen e mjedisit detar në vitin 2024, si dhe planeve të baseneve për disa lumenj, por furnizimi me ujë dhe kanalizime mbetet i ulët dhe kërkon financime të mëdha, rritje kapacitetesh dhe një program kombëtar monitorimi. Përafrimi në mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit është i avancuar, megjithatë ndryshimet ligjore të vitit 2024 dhe projektet infrastrukturore në zonat e mbrojtura, si aeroporti i Vlorës në Pishë Poro–Nartë, bien ndesh me standardet e BE-së.

Situata është gjithashtu problematike në fushën e ndotjes industriale, kimikateve, biocideve dhe zhurmës, ku nuk ka përparim të prekshëm.

Në mbrojtjen civile, miratimi i Planit Kombëtar për Emergjencat Civile dhe vlerësimi i riskut janë hapa pozitivë, por sistemi mbetet i brishtë dhe ka nevojë për rritje të ndjeshme të kapaciteteve operacionale dhe të paralajmërimit të hershëm.

Sa i përket ndryshimeve klimatike, raporti vë në dukje se, Shqipëria mbetet në një nivel përgatitjeje të kufizuar, pa një integrim të plotë të politikave klimatike në strategjitë sektoriale dhe me burime të pamjaftueshme financiare e njerëzore. Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën duhet të përditësohet, regjistri i emetimeve mungon dhe mbështetja te pyjet për thithjen e CO<sub>2</sub> nuk shoqërohet me masa të mjaftueshme për ruajtjen e tyre. Ndërkohë është nisur rishikimi i Planit Kombëtar të Përshtatjes, por për të avancuar drejt BE-së, vendi duhet të zbatojë paketën MRVA deri në fund të vitit 2025, të vendosë çmimin e karbonit dhe të përafrohet me sistemin evropian të tregtimit të emetimeve (EU ETS), si dhe të miratojë një strategji afatgjatë për emetimet e ulëta dhe një kontribut kombëtar të ri të përcaktuar, duke u përafuar me paketën “Fit for 55”.<sup>53</sup>

### Auditime të KLSH

KLSH, gjatë veprimtarisë së saj audituese vitet e fundit dhe në përputhje me kërkesat e BE-së dhe organizmave të larta të auditimit të jashtëm publik ku bën pjesë, si INTOSAI, EUROSAI etj., ka kryer auditime të shumta të performancës nga pikëpamja mjedisore.

- Në vitin 2021, KLSH ka realizuar auditimin e performancës me temë “Pastrimi i Qytetit”, ushtruar në Bashkinë Vlorë. Sipas këtij auditimi, shërbimi i pastrimit të qytetit ka rezultuar pjesërisht efektiv. Mangësi vërehen në procesin e planifikimit, kryesisht atë financiar, ku Bashkia Vlorë shpenzon një vlerë të konsiderueshme për pastrimin e qytetit, e cila nuk

<sup>53</sup> Raportit i Komisionit Evropian 2024, Kapitulli 27, fq. 85-87:  
[https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Albania+Report+2024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf)

mbulohet dot nga të ardhurat e mbledhura për pastrimin. Po kështu, kontrata e lidhur mes palëve nuk është zbatuar me rigorozitet, pasi ka shumë elementë të përcaktuar në të, të cilët janë neglizhuar dhe gjithashtu ka mungesë transparence në garantimin e përmbushjes së çdo zëri të kontratës. Me gjithë përpjekjet e deritanishme, vëmendja duhet të jetë më e madhe drejt ndërmarrjes së studimeve dhe planifikimit të shërbimeve, në proporcion me burimet financiare në dispozicion të Bashkisë, si dhe kërkesës së shtuar të llogarisë ndaj operatorëve ekonomikë.

- Në auditimin e performancës me temë “Menaxhimi i mbetjeve plastike”, ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë, KLSH arriti në përfundimin se, MTM dhe bashkitë e sipërcituara nuk kanë qenë efektive sa i përket menaxhimit të mbetjeve plastike për periudhën 2017-2020. Mangësi të theksuara janë vërejtur në hartimin dhe miratimin e kuadrit ligjor e rregullator të nevojshëm për menaxhimin e mbetjeve plastike. MTM nuk ka hartuar programet e parandalimit të krijimit të mbetjeve dhe nuk ka raportuar asnjëherë në Këshillin e Ministrave mbi Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, ndërsa Bashkia Tiranë dhe Vlorë nuk kanë hartuar dhe miratuar Planet Vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë nuk kanë krijuar infrastrukturën e nevojshme për të bërë të mundur grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim dhe objektivi kryesor për përdorimin dhe riciklimin e plastikës me 22.5 %, kundrejt volumit total që krijohet në këto bashki, nuk është arritur dhe nuk do të arrihet për aq kohë sa infrastruktura do të jetë kjo që është. Aktivitetet informuese dhe edukuese që Bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë, do të duhej të arrinin nëpërmjet kompanive private që kryejnë shërbimin e pastrimit të qytetit dhe që kanë detyrimin për edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve nuk janë arritur.

- Në auditimin e performancës me temë “Incineratori i Tiranës” në vitin 2022, ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkinë Tiranë, KLSH arriti në përfundimin se, politikat e Ministrisë së Mjedisit (sot MTM) për reduktimin e mbetjeve kanë rezultuar të paqarta dhe të pafokusuara, duke mos qenë në linjë me objektivat kombëtare dhe evropiane. Procesi i planifikimit të projektit të incineratorit të Tiranës është shoqëruar me mungesa të rëndësishme: propozimi paraprak dhe miratimi nga Ministria e Financave nuk janë kryer siç duhet, duke krijuar pasiguri mbi implikimet fiskale dhe financiare të projektit. Mungesa e përgjigjeve dhe dakordësive të institucioneve të tjera qendrore ka devijuar procesin, duke lënë pa u identifikuar risqe të mëdha, përfshirë koston e shpronësimeve dhe rrezikun nga çmimi i energjisë. Gjithashtu, mosdakordësimi i bashkive të tjera të qarkut, përveç Bashkisë Tiranë, ka krijuar mundësi për kosto shtesë në të ardhmen dhe ka ulur efektivitetin e projektit. Tarifa prej 29 euro/ton e mbetjeve, e cila paguhet nga Bashkia Tiranë, nuk pasqyron realisht shërbimin, pasi përfshin edhe incenerimin që ende nuk është kryer, duke dyfishuar shpenzimet e bashkisë. Për më tepër, procedura konkurruese për dhënie të kontratës nuk është zbatuar, në përputhje me ligjin dhe parimet e transparencës, ndërsa projekti ka pësuar vonesa të mëdha për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve të autoritetit kontraktor dhe koncesionarit, duke rrezikuar efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e tij.

- Në auditimin e performancës me temë “Efektiviteti i politikave mjedisore në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” në vitin 2022, ushtruar në Bashkinë Tiranë; Vlorë, Fier, Lezhë,

Shkodër, Pogradec dhe Korçë, KLSH arriti në përfundimin se, edhe pse mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi është përcaktuar si një përparësi kombëtare dhe një detyrim për organet shtetërore, ajo nuk ka marrë vëmendjen e duhur nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë periudhës 2018–2021. Në shumicën e tyre mungojnë struktura të posaçme për hartimin e politikave mjedisore dhe nuk është siguruar mbështetje e mjaftueshme buxhetore. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet aktorëve lokalë e qendrorë mbetet i dobët, ndërsa sistemi i raportimit për politikat mjedisore nuk ekziston. Zbatimi i politikave kombëtare në nivel lokal nuk është bërë në përputhje me kërkesat ligjore, dhe në rastet kur janë ndërmarrë iniciativa, ato nuk janë shoqëruar me analiza apo vlerësime të ndikimit. Gjithashtu, proceset e informimit dhe përfshirjes së publikut, si dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve për çështjet mjedisore, janë ende të pamjaftueshme dhe kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

- Në auditimin e performancës me temë “Menaxhimi i burimeve ujore” në vitin 2022, ushtruar në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, KLSH arriti në përfundimin se, masat e marra nga institucionet përgjegjëse lidhur me menaxhimin e përdorimit të burimeve ujore kanë qenë pjesërisht efektive dhe eficiente. Edhe pse, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore si një institucion i krijuar në vitin 2018 ka bërë hapa pozitivë në kuadër të përmirësimit të situatës në tërësi, evidentohen mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore, ose akte nënligjore të pa përditësuara dhe që nuk përputhen me ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar me ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018. Aktivitetet e parashikuara për arritjen e objektivave strategjike për menaxhimin e ujit nuk u mbështetën me buxhetet e nevojshme, pasi për periudhën nën auditim u alokuan 60% më pak fonde se ato të nevojshme referuar Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SKMBIU), çka përmban riskun e mos zbatimit me efektivitet të tyre. Për periudhën 2018-2021, nuk janë hartuar Raporte Vjetore të Monitorimit mbi implementimin e SKMBIU dhe planit të parë të veprimit, duke mos adresuar shkaqet që kanë cënuar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë, siç është edhe mungesa e fondeve. AMBU nuk ka arritur të maksimizojë mbledhjen e të ardhurave të veta, prej mos aplikimit për leje të subjekteve private dhe publike që aktualisht përdorin burimet ujore, por edhe si pasojë e mosarkëtimit të debitorëve (edhe pse vihet re një përmirësim i situatës për periudhën në auditim krahasuar me periudhën e para vitit 2018). Numri i subjekteve, që përdorin burime ujore pa leje për qëllime dhe aktivitete të ndryshme, vazhdon të jetë shumë herë më i lartë se ata që janë me leje/autorizim dhe që faturohen/arkëtohen nga AMBU. Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitutional, veçanërisht sa i përket kontrollit dhe inspektimit të përdoruesve të jashtëligjshëm të burimeve ujore, por dhe mungesa e burimeve njerëzore e logjistike në institucionet përgjegjëse, janë ndër arsyt kryesore të një menaxhimi jo efektiv të burimeve ujore në vend.

- Në auditimin e performancës me temë “Efektiviteti i politikave në ruajtjen dhe administrimin e lagunave” në vitin 2022, ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), KLSH arriti në përfundimin se zonat detare e bregdetare janë më të pasurat në biodiversitet. Aktualisht, lagunat janë ekosistemet më të përfaqësuara në bregdetin shqiptar, të cilat kanë rol mjaft të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të klimës globale, zhvillimit të qëndrueshëm

dhe biodiversitetit. Ruajtja e tyre është thelbësore për mbrojtjen e biodiversitetit, si dhe arritjen e objektivave kombëtar dhe ndërkombëtar në kuadër të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Pavarësisht faktit se lagunat gjenden totalisht brenda zonave të mbrojtura, nuk kanë patur vëmendjen e nevojshme dhe nuk i kanë shpëtuar problematikave të ndërtimeve të padisplinuara, ndotjes, tjetërsimit, apo shfrytëzimit pa kriter. Sa i përket ruajtjes dhe administrimit të tyre, nga ana e institucioneve përgjegjëse kanë munguar politika të qarta dhe të mbështetura në studime si dhe masat e nevojshme për një monitorim permanent dhe efektiv. Mangësitë në bazën ligjore ekzistuese, mbivendosja e strukturave dhe kompetencave, mungesa e kontrolleve konsistente, bashkëveprimi i pamjaftueshëm ndër-institucional, si dhe buxhetet e pamjaftueshme të akorduara, kanë ndikuar negativisht në ruajtjen dhe mirëadministrimin e këtyre ekosistemeve. Për rrjedhojë, problematikat e evidentuara kërkojnë zgjidhje të shpejta dhe të qëndrueshme nga ana e institucioneve përgjegjëse në mbrojtje të këtyre pasurive të rëndësishme kombëtare.

- Në auditimin e performancës me temë “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”, ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në vitin 2023, KLSH arriti në përfundimin se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të nxisin rinovimin e flotës së mjeteve rrugore, vënien në zbatim të stimujve financiare për të shtuar numrin e mjeteve rrugore me emetim të ulët, plotësimin e legjislacionit në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare si dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit.

- Në auditimin e performancës me temë “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfida e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë”, ushtruar në Bashkinë Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë në vitin 2024, KLSH arriti në përfundimin se, menaxhimi i mbetjeve urbane vijon të mbetet një sfida e vazhdueshme për Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë. Këto bashki nuk kanë garantuar menaxhim të integruar të mbetjeve urbane, duke mos zbatuar hierarkinë e mbetjeve në drejtim të parandalimit, ripërdorimit, reduktimit dhe riciklimit. Gjithashtu, këto bashki nuk kanë arritur të minimizojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve për të përfutur të ardhura nëpërmjet metodologjisë së trajtimit të tyre. Në veçanti, në Bashkinë Durrës, menaxhimi i mbetjeve urbane nuk garanton qëndrueshmëri financiare, sepse nuk mbulohen shpenzimet me të ardhurat e krijuara. Ndërsa, menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Vlorë përveç se nuk respekton standardet mjedisore, shkakton probleme serioze shëndetësore në komunitet si dhe efekte negative në ekonominë lokale dhe turizmin bregdetar. Është e rëndësishme që këto bashki të angazhohen për të ndryshuar këtë situatë dhe për të krijuar një mjedis sa më të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë.

- Në auditimin e performancës me temë “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”, ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) në vitin 2024, KLSH arriti në përfundimin se gjatë dy dekadave të fundit, sfida e ndryshimeve klimatike është përballur me një qasje për përgjegjësi të përbashkët në nivel ndërkombëtar. Kjo përfshin përpjekje për shtimin e masave të përshtatjes për të luftuar ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike, që janë ndërkaq të pashmangshme. Nëpërmjet hartimit të Planit Kombëtar të Përshtatjes, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit synon marrjen e

masave të suksesshme, me qëllim kundërpërgjigjen ndaj ndryshimeve klimatike. Megjithatë, pavarësisht veprimeve prioritare të përcaktuara, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka luajtur një rol proaktiv në respektim të nismës integruese gjithëpërfshirëse për procesin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, si një qasje relativisht e re, ende nuk mbështetet me kapacitete të përshtatshme në vend. Nuk është krijuar një sistem i mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi dhe pjesa më e madhe e financimit të klimës në Shqipëri është shumë e varur nga komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët. Në vijim, është e rëndësishme që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa, me qëllim që procesi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të jetë më efektiv, duke siguruar zbatimin e masave dhe nxjerrjen e mësimave në mënyrë periodike.

- Në auditimin e performancës me temë “Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor”, ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Bashkitë Selenicë, Skrapar, Krujë, Dimal, Berat, në vitin 2025, KLSH arriti në përfundimin se, masat e marra nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e fondit pyjor nuk kanë rezultuar të mjaftueshme. Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor dhe Sistemi i Integruar i Informacionit për pyjet nuk funksionojnë, duke mos garantuar një informacion të plotë e të përditësuar mbi fondin pyjor. Vetëm 7 nga 87 subjekte, që operojnë në sektorin minerar në territorin e bashkive subjekt auditimi, janë të pajisura me dokumentin e miratimit të heqjes së fondit pyjor, duke sjellë kështu mos përditësimin e regjistrit kadastral të fondit pyjor, me pasojë mungesën e rehabilitimit dhe mos kryerjen e pyllëzimit kompensues. Përgjegjës kryesor për këtë situatë është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Bashkitë Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal, nuk ka pasur inspektime dhe monitorime periodike për aktivitetin minerar që ndikon në fondin pyjor të subjekteve në lidhje me detyrimet për rehabilitimin e mjedisit, ripyllëzimet, parandalimin e dëmtimit të fondit pyjor dhe ruajtjen e tij nga aktiviteti i paligjshëm. Angazhimi i të gjitha institucioneve të sipër përmendura është i rëndësishëm për përmirësimin e situatës në tërësi.

### **Të tjera**

Çështjet mjedisore kanë qenë dhe janë në fokusin kryesor të auditimeve të performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit, kjo si për vizionin strategjik të KLSH, ashtu edhe për mundësinë e krijuar për të realizuar auditime paralele performance me perspektivë mjedisore me SAI të tjera. Kujtojmë se, Departamenti i Auditimit të Performancës ka realizuar në vitet e fundit një sërë auditimesh paralele mbi tematika mjedisore, si dhe në bashkëpunime me SAI ndërkombëtarë si ai i Norvegjisë, auditime me temë “Menaxhimi i mbetjeve plastike”, “Ndotja e menjëhershme e Detit Adriatik dhe Jon”, “Cilësia e ajrit”, “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”, “Menaxhimi i burimeve ujore” etj. Aktualisht me mbështetjen e Institucionit Suprem të Auditimit të Norvegjisë, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH është duke kryer auditimin me temë “Cilësia e ujërave në plazhe”, i cili pritet të evadohet në Tetor 2025. Disa nga risqet kryesore me të cilat ballafaqohen institucionet që menaxhojnë çështjet e mjedisit kanë të bëjnë me:

- vërtetësinë e të dhënave, të cilat publikohen në raporte të ndryshme zyrtare (si për shembull sa i përket sasisë së prodhuar të mbetjeve, cilësisë së ajrit, nivelit të zhurmave etj.);
- monitorimi i cilësisë së mjedisit (si për shembull monitorimi i ajrit, zhurmave, ujërave, mbetjeve, etj);
  - kontrolli dhe inspektimi, duke patur në konsideratë logjistikën e cunguar dhe të mangët të inspektorëve të mjedisit;
- ndryshimet strukturore të varësisë së inspektoriatit mjedisit nga MTM në varësi të IKMT.
- koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstucional;
- mungesë të burimeve njerëzore si rezultat i vakancave në pozicione të ndryshme që kanë të bëjnë me çështje të ndryshme mjedisore;
- mangësi në buxhetim të zërave dhe programeve të ndryshëm për çështje të ndryshme mjedisore etj.

## II. 6 ENERGJIA

### Vizioni strategjik

Dokumenti më i rëndësishëm për sektorin e energjisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 – “Shqipëria 2030”, që shërben si një udhërrëfyes që vendos piketat kryesore për modelet e zhvillimit të një prej promotorëve kryesorë të ekonomisë.

Parimet që udhëheqin zhvillimin e kësaj strategjie të energjisë janë në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II (SKZHI II), në mënyrë specifike, për:

- Rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, ndërsa sigurohet rritje në mirëqenie;
- Zhvillimin e burimeve kombëtare të energjisë, diversifikimin e burimeve të furnizimit dhe ndërlidhjen me rrjetet evropiane të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në përputhje me acquis të Traktatit të Komunitetit të Energjisë;
- Krijimin e një tregu konkurrues që ofron sinjale korrekte për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike dhe gazit natyror;
- Ofrimin e incentivave për zbatimin e politikave të nevojshme të ndryshimeve klimatike.

Objektivat strategjikë të identifikuar për të realizuar parimet udhëzuese dhe angazhimet aktuale, që janë ndërmarrë nga qeveria shqiptare, janë si më poshtë:

- Përmirësimi i besueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit me energji;
- Zhvillimi i burimeve të brendshme të energjisë primare në një mënyrë të qëndrueshme dhe konkurruese;
- Përmirësimi i efektivitetit të kostove të sistemeve të furnizimit me energji; - Arritja e objektivave për burimet e rinovueshme të energjisë dhe eficiencën e energjisë të përcaktuara në Planet Kombëtare të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe për Burimet e Rinovueshme të Energjisë;
- Zhvillimi i politikave dhe strategjive me kosto efektive për rritjen e performancës së energjisë në ndërtesat publike dhe ato rezidenciale;
- Integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe të gazit natyror me Kosovën, rajonin dhe tregjet evropiane;
- Arritjen e objektivave të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (NDC) për reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serë (GHG).

### Qëndrimi ose këndvështrimi ndërkombëtar

Sipas Raportit të Komisionit Evropian 2024<sup>54</sup>, sa i përket energjisë, Shqipëria është ndërmjet një niveli mesatar dhe të mirë të përgatitjes në këtë fushë. Është bërë përparim i mirë, veçanërisht në tregun e brendshëm të energjisë elektrike. Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë adresuar pjesërisht dhe mbeten pjesërisht të vlefshme.

Krahas adresimit të mangësive të përcaktuara më sipër, Shqipëria duhet veçanërisht:

- të përditësojë dhe zbatojë Planin Kombëtar të Integruar të Energjisë dhe Klimës (NECP) 2020-2030, duke siguruar që operatori shqiptar i energjisë së rinovueshme të jetë plotësisht funksional deri në fund të vitit 2024;
- të forcojë kapacitetin e Agjencisë së Eficiencës së Energjisë, të vijojë hartimin dhe miratimin e legjislacionit zbatues (përfshirë vendosjen e skemës së detyrimit për eficiencën e energjisë), si dhe të miratojë aktet nënligjore mbi etiketimin, në përputhje me detyrimet sipas Direktivës për Eficiencën e Energjisë;
- të vazhdojë zbatimin e paketës së integritimit të tregut të energjisë elektrike dhe, në veçanti, të bashkohet me tregun e përbashkët evropian të energjisë “day-ahead” deri në qershor 2026.

### Auditime të KLSH

Në Janar të vitit 2023, KLSH ka realizuar auditimin e performancës me temë “Performanca e shoqërive publike të sektorit energjetik në administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021-2022”.

Ky auditim ka përfshirë institucione si: Enti Rregullator i Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit SHA dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare SHA dhe në fokus ka pasur administrimin e rezervave hidrike në kaskadën e lumit Drin.

Në përfundim të këtij auditimi, KLSH arriti në përfundimin se, Kriza globale energjetike u shoqërua me rritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga importi dhe me mungesë të likuiditeteve financiare të shoqërive të sistemit elektroenergjetik shqiptar, duke vështirësuar garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit dhe furnizimin e pandërprerë me energji elektrike. Keqmenaxhimi i kaskadës së Drinit solli si pasojë rënien e rezervës hidroenergjetike në liqenin e Fierzës dhe rritjen e kërkesës për import të energjisë elektrike, në një periudhë që përkon me çmime shumë të larta të energjisë elektrike në bursë. Ndodhur në këto kushte, Qeveria Shqiptare injektoi nëpërmjet instrumenteve financiarë 165 milion euro dhe 20 miliard lekë, që sistemi elektroenergjetik të mos kalonte në kolaps. Vlera e importit të energjisë elektrike për 6 mujorin e parë të 2022 u rrit me 156%, krahasuar me vlerën e këtyre importeve për vitin 2021. Shpenzimet për blerjen e energjisë nga importi për vitin 2021 dhe 6 mujorin e parë 2022 arritën vlerën 659,982,839 euro. Strategjitë e ndjekura nga sistemi për diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike, kanë rezultuar deri tani jo eficiente, duke sjellë ekspozimin e përhershëm të sistemit elektroenergjetik kundrejt riskut meteorologjik. Kjo ka sjellë, si pasojë, rritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga importi me çmime të larta. KESH, përveç disa nismave fillestare në investime për burime foto volta-ike (PV), është larg realizimit të objektivave strategjike, për diversifikimin e portofolit gjenerues, me energji të rinovueshme. Një nga sfidat e tjera të sistemit, ngelet niveli i lartë i humbjeve në shpërndarjen e energjisë elektrike, e vlerësuar 21% për 2021 dhe 20% në 2022. Niveli i lartë i humbjeve është pasojë e investimeve të

<sup>54</sup> Sipas kapitullit 15 të Progres Raportit të Shqipërisë për vitin 2024 [Albania Report 2024 - European Commission](#)

pamjaftueshme në infrastrukturën e sistemit të shpërndarjes dhe mos implementimit të sistemit inteligjent të matjes. Siguria kibernetike, gjithashtu, mbetet një çështje sensitive, në kushtet kur sistemi elektroenergetik është i klasifikuar, si infrastrukturë kritike e rëndësisë së veçantë për sigurinë kombëtare. Garantimi i sistemeve të informacionit dhe ruajtja e të dhënave korporatave kërkon që shoqëritë e sektorit elektroenergetik të certifikohen me standardin ISO 27001. Krahas masave të marra për përballimin e krizës së energjisë elektrike, Qeveria Shqiptare duhet të gjejë zgjidhje të qëndrueshme dhe eficiente për vënien në funksion të TEC-it të Vlorës, si dhe fillimin e operimit të bursës shqiptare të energjisë, për ta bërë të plotë modelin e tregut të energjisë.

- Gjithashtu, KLSH në muajin Tetor 2024 ka realizuar auditimin e përputhshmërisë në “Agjencinë për Eficencën e Energjisë”, në të cilin janë evidentuar mangësi serioze në menaxhimin administrativ, financiar dhe teknik gjatë periudhës 2019–2023, duke mos përmbushur detyrimet ligjore dhe funksionale. Këto problematika kanë ndikuar negativisht në efektivitetin e investimeve publike dhe në realizimin e objektivave të efikasitetit të energjisë në nivel kombëtar.

### **Të tjera**

Me vendimin nr. 519, datë 13.7.2016, Këshilli i Ministrave hapi rrugën për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë, një mekanizëm kyç për zhvillimin e tregut të lirë të energjisë në vend. Në tetor 2020, u themelua shoqëria aksionare ALPEX (Albanian Power Exchange), me pjesëmarrjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) nga Shqipëria dhe KOSTT nga Kosova. Kjo nismë synon të nxisë investime të reja në prodhimin dhe transmetimin e energjisë, si dhe të përmirësojë përdorimin e burimeve ekzistuese, duke promovuar transparencën dhe konkurrencën në tregun energjetik. Pas përgatitjeve shumëvjeçare, ALPEX u bë funksionale në prill 2023, me nisjen e operimit të tregut ditor (day-ahead market) në Shqipëri dhe më pas me integrimin e tregut të Kosovës në shkurt 2024, çka shënoi një hap të rëndësishëm drejt harmonizimit me modelin evropian të tregut të energjisë dhe bashkëpunimit rajonal. Në kuadër të diversifikimit të burimeve të furnizimit me energji, Qeveria Shqiptare ka promovuar ndërtimin e parqeve fotovoltaike, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë. Prodhimi i energjisë nga burime diellore konsiderohet një element kyç për reduktimin e varësisë nga hidroenergja dhe tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, proceset e kontraktimit dhe zbatimit të projekteve koncesionare, si në rastin e parkut fotovoltaike të Akërnisë, kanë sjellë problematika, të cilat kërkojnë vëmendje të shtuar nga institucionet përgjegjëse, për të shmangur rreziqet financiare që mund të burojnë nga procese gjyqësore të brendshme apo ndërkombëtare (arbitrazhe). Në këtë kontekst, auditimet e performancës do të orientohen drejt këtyre fushave me risk të lartë, për të garantuar menaxhim të qëndrueshëm dhe efektiv të financave publike në sektorin energjetik.

## **II. 7 TREGU I PUNËS**

### **Vizioni strategjik**

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030 përmban në mënyrë të përmbledhur elementët si më poshtë:

**1. Vizioni dhe objektivi i përgjithshëm-** “Një treg pune gjithëpërfshirës, elastik dhe i qëndrueshëm, që u mundëson të gjithë qytetarëve të zhvillojnë aftësitë e nevojshme dhe të përfitojnë nga punësimi cilësor.”

**2. Katër përparësitë strategjike (pillars),** të cilat përfaqësojnë një qasje gjithëpërfshirëse për zhvillimin e tregut të punës dhe forcimin e kapitalit human dhe çdo përparësi ka objektiva specifike, rezultate të pritshme dhe tregues matës. Përparësitë janë si më poshtë:

*I. Rritja e punësimit të qëndrueshëm dhe cilësor përmes:*

- Zhvillimit të një tregu pune gjithëpërfshirës dhe fleksibël, që nxit punësimin formal dhe punën e denjë;
- Zgjerimit të gamës dhe përmirësimit të cilësisë së programeve aktive të tregut të punës (PATP);
- Modernizimit të Shërbimit Publik të Punësimit dhe forcimit të kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (AKPA);
- Zhvillimit të mekanizmave për matjen dhe monitorimin e rezultateve të politikave të punësimit;
- Uljes së punësimit informal dhe nxitjes së formalizimit përmes instrumenteve ligjore, fiskale dhe mbështetëse.

*II. Zhvillimi i aftësive dhe përputhja me kërkesat e tregut, përmes:*

- Rritjes së cilësisë dhe përfshirjes në arsimin dhe formimin profesional (AFP);
- Forcimit të lidhjes midis arsimit, formimit dhe tregut të punës, përmes kurrikulave të bazuara në kompetenca dhe praktikave në punë;
- Zhvillimit profesional të mësuesve dhe stafit mbështetës në institucionet e AFP-së;
- Fuqizimit të mekanizmave për parashikimin e nevojave për aftësi dhe informacionin e tregut të punës;
- Rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve, grave dhe grupeve vulnerabël në programet e aftësimit.

*III. Nxitja e përfshirjes sociale dhe barazisë në tregun e punës, përmes*

- Zgjerimit të aksesit në shërbime të punësimit për grupet vulnerabël, të rinjtë që nuk janë në punë, arsim apo trajnim (NEET), dhe të papunët afatgjatë;
- Ofrimit të mbështetjes së synuar për zonat rurale dhe komunitetet e marginalizuara;
- Promovimit të punësimit të barabartë dhe eliminimit të diskriminimit gjinor e etnik në tregun e punës;
- Riintegrimin të emigrantëve të kthyer dhe reduktimit të flukseve të largimit për arsye punësimi.

*IV. Forcimi i qeverisjes dhe institucioneve të tregut të punës, përmes:*

- Rritjes së kapaciteteve institucionale dhe financiare të AKPA, strukturave rajonale dhe lokale;
- Përmirësimit të kuadrit ligjor për tregun e punës dhe sistemin e kualifikimeve, në përputhje me standardet e BE-së;
- Forcimit të dialogut social trepalësh dhe i përfaqësimit të sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve;
- Zhvillimit dhe zbatimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe mekanizmave të sigurimit të cilësisë;
- Digjitalizimit të shërbimeve dhe zhvillimit të sistemeve të informacionit për tregun e punës dhe AFP.

**3. Qasja e re e “ekosistemeve të aftësive dhe punësimit”, një element i paraqitur rishtazi krahasuar me strategjinë e mëparshme, që nënkupton:**

- bashkëveprim të koordinuar midis arsimit, formimit profesional, biznesit, punësimit dhe inovacionit;
- zhvillimin e partneriteteve territoriale (ekosisteme rajonale për aftësitë);
- përfshirjen e aktorëve lokalë, dhomave të biznesit, organizatave të punëdhënësve dhe shoqërisë civile në hartimin e programeve të aftësimit;
- përdorimin e të dhënave të tregut të punës dhe parashikimit të aftësive për planifikim më të mirë të politikave.

**4. Qeverisja dhe menaxhimi i strategjisë përcakton faktorët bashkërendues:**

- Roli drejtues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përmes AKPA);
- Krijimi i Komitetit Ndërinstitucional të Punësimit dhe Aftësive;
- Raportim periodik dhe monitorim i indikatorëve të rezultateve;
- Integrimi me procesin e Programimit Afatmesëm Buxhetor (PBA).

**5. Plani i veprimit dhe kostot financiare**

Ka një Plan Veprimi 2023–2026 të bashkëlidhur që përmban:

- masa konkrete për secilën përparësi,
- institucionet përgjegjëse,
- afatet e zbatimit,
- burimet financiare dhe treguesit e matjes.

**6. Ndërlidhja me procesin e integritit në BE dhe dokumentet e BE**

Strategjia është harmonizuar me:

- Paktin Evropian për Aftësitë (European Skills Agenda)
- Strategjinë Evropiane për Punësim dhe Rininë
- Raportet e Komisionit Evropian (2023–2024) për Shqipërinë si dhe përfshin detyrime për transpozimin e direktivave të BE-së mbi shëndetin dhe sigurinë në punë, barazinë gjinore, të drejtat në punë etj.

**Qëndrimi ose këndvështrimi ndërkombëtar (2024)**

Shqipëria paraqet një nivel të mesëm përgatitjeje për politikat sociale dhe punësimin, duke avancuar në drejtim të forcimit të kapaciteteve të institucioneve të tregut të punës, si dhe në ofrimin e shërbimeve aktive të punësimit për grupet vulnerabël, në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030.<sup>55</sup> Në lidhje me legjislacionin e punës, Kodi i Punës është në zbatim dhe është ndërmarrë një proces përmirësimi i kapaciteteve të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale, përfshirë zbatimin e platformës së e-inspektimit. Megjithatë, kapacitetet njerëzore dhe burimet financiare mbeten të kufizuara, duke ndikuar në zbatimin dhe monitorimin efektiv të legjislacionit për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe në promovimin e punës së denjë. Shqipëria ka përshtatur pjesën kryesore të Direktivës Kuadër të BE-së për shëndetin dhe sigurinë në punë, por korniza e re e politikave kërkon zhvillim të mëtejshëm në përputhje

---

<sup>55</sup> Komisioni Evropian, *Raporti i Zgjerimit për Shqipërinë 2024*, seksioni 2.7.2 Politikat sociale dhe punësimi (f. 104–106); MFE, *Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030*, f. 23–24, 42–45.

me Strategjinë e BE-së 2022–2027. Zbatimi praktik mbetet i kufizuar për shkak të mungesës së personelit të specializuar dhe të mjeteve për inspektimet në terren. Dialogu social nuk ka përparuar, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, i penguar nga numri i ulët i sindikatave aktive, mungesa e kulturës së dialogut dhe skepticizmi i punëdhënësve ndaj organizimit sindikal<sup>56</sup>. Pavarësisht se kuadri ligjor përcakton kriteret për përfaqësimin në Këshillin Kombëtar të Punës, kjo strukturë nuk është ende funksionale dhe mbledhjet e nënkomisioneve nuk zhvillohen rregullisht. Gjithashtu, Këshillat Konsultativë Rajonalë, të parashikuar me ligj, nuk janë bërë ende funksionalë në praktikë.

### Auditime të KLSH

KLSH ka realizuar Auditimin me temë “*Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës*”, ku subjektet e audituara kanë qenë: Agjencia Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe 13 bashki të vendit të cilat janë: Bashkia Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnje, Pogradec, Berat, Vlorë, Gjirokastrë.

Ky auditim kishte si objektiv kryesor vlerësimin e shërbimeve të ofruara për nxitjen e punësimit të grave në zonat rurale, duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë në realizimin e objektivave të tyre institucionale. AKPA ka si detyrë të sigurojë përmbushjen e të drejtës së shtetasve, për t’u trajtuar me shërbime dhe programe publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimeve profesionale, me qëllim gjetjen e një pune të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve. Nga ana tjetër, bashkitë e vendit kanë detyrimin të sigurojnë qeverisjen e efektshme dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Numri i lartë i subjekteve të përzgjedhura u bë për të vlerësuar angazhimin e institucioneve në nivel vendor lidhur me nxitjen e punësimit të grave në zonat rurale në territorin e tyre. Megjithëse në Shqipëri gratë luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e bujqësisë, pasi përbëjnë rreth 55% të forcave të punës, ato drejtojnë vetëm 7% të fermave bujqësore dhe blegtorale të vendit. Janë të shumta sfidat dhe kushtet me të cilat punojnë gratë në zonat rurale. Në procedurat e ndjekura për t’u përfshirë në tregun e punës ato shpesh hasin problematika si për shembull: për të bërë aplikime, për të hapur një biznes, apo për të drejtuar një biznes në këto prona etj. Faktorë të tjerë që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në punësimin e grave nga zonat rurale janë edhe problematika që dalin nga infrastruktura, zona ku jetojnë, mungesa e transportit, ujit të pijshëm, mungesa e qendrave shëndetësore 24 orë si dhe e çerdheve dhe kopshteve me drekë. Nga auditimi ka rezultuar se, nxitja e programeve të punësimit (për vitet 2020-2023) për gratë janë të përgjithshme dhe nuk japin plotësisht panoramën e gjithë rajoneve referuar vlerësimit të nevojave. Infrastruktura vendore nuk nxit përfshirjen e grave rurale në tregun e punës, pasi në zonat rurale mungojnë çerdhet, ndërsa shërbimi i kopshteve nuk ofrohet në të gjitha njësitë administrative rurale, si dhe mungon transporti publik nga njësia qendër drejt të gjitha njësiteve administrative të bashkive. AKPA nuk ka ngritur pika shërbimi në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat nuk kanë zyra vendore punësimi, sikundër është përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Komunikimi midis strukturave qendrore dhe vendore nuk identifikon nevojat e grave në përgjithësi dhe grave rurale në veçanti. Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të merren nga AKPA lidhur me nevojat reale të grave në zonat rurale për shërbimet e programeve të nxitjes së punësimit, në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të këtyre programeve, duke

<sup>56</sup> Komisioni Evropian, *Raporti i Zgjerimit për Shqipërinë 2024*, seksioni mbi dialogun social, fq 76.

përfshirë edhe kategorinë “gra në zonat rurale”, bashkëveprimin me Ministrinë e Financave për zonat dhe sektorët prioritarë, kryerjen e planifikimeve të nevojshme buxhetore në këtë drejtim, zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për hapjen e kurseve profesionale, monitorimin e kushteve të marrëveshjeve të lidhura me bashkitë, si dhe monitorimin në vijimësi të aktiviteteve të zhvilluara në përmbushje të objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore është rekomanduar marrja e masave për të vlerësuar situatën aktuale në zonat rurale, mbulimin e tyre me çerdhe dhe kopshte, si dhe hartimin e planeve të investimit në varësi të nevojave, mbulimin e zonave me transport publik dhe lidhjen e tyre me zonat urbane etj.

### **Të tjera**

Në vitin 2024, tregu i punës në Shqipëri ka vijuar zvvillimin me ritme të qëndrueshme, megjithatë, disa sfida të mëdha mbeten të pranishme, duke kërkuar vëmendje të shtuar nga institucionet përgjegjëse.

Referuar të dhënave të INSTAT të tregut të punës si: forca e punës, shkalla e punësimit e papunësisë, rezulton një treg pune që po zhvillohet, por që ende përballlet me sfida të konsiderueshme, veçanërisht në lidhje me punësimin e të rinjve dhe grupet e tjera vulnerabël.

### **Fushat me Risk dhe Objekt Auditimi për KLSH**

Bazuar në analizën e tregut të punës dhe sfidat e identifikuara, disa fusha specifike me risk që mund të jenë objekt auditimi për Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH) janë:

- Programet e nxitjes së punësimit: Vlerësimi i efektivitetit të programeve që synojnë krijimin e mundësive të punës për të rinjtë dhe grupet vulnerabël.
- Ofrimi i shërbimeve të punës për grupet vulnerabël: Analiza e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara, gra, të rinj dhe individë nga grupe të tjera të marginalizuara.
- Arsimi dhe formimi profesional: Vlerësimi i përshtatshmërisë së programeve arsimore dhe trajnimeve profesionale me kërkesat e tregut të punës.
- Inspektimi i sigurisë në punë: Analiza e efikasitetit të inspektimeve dhe masave të marra për të garantuar kushte të sigurta pune për të gjithë punonjësit.
- Këto fusha mund të konsiderohen me risk të lartë dhe kërkojnë vëmendje të veçantë për të siguruar një treg të punës më të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

## **II. 8 ADMINISTRATA PUBLIKE**

### **Vizioni strategjik**

Vizioni strategjik i qeverisë shqiptare për administratën publike është përditësuar me Strategjinë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2022 - 2030, e miratuar në vitin 2022, e cila pason Strategjinë e mëparshme 2015 - 2022. Kjo strategji përcakton objektivat dhe prioritetet kryesore në katër fusha:

- (a) politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit;
- (b) organizimi dhe funksionimi i administratës publike;
- (c) shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
- (d) ofrimi i shërbimeve publike dhe procedurat administrative.

Ajo është e ndërlidhur ngushtë me Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), i cili mbetet mekanizmi kryesor për përcaktimin e prioriteteve strategjike dhe alokimin e burimeve, duke synuar rritjen e koherencës midis politikave publike dhe harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian.

Sa i përket procesit legjislativ, ka pasur në strukturimin e analizave dhe planifikimit të masave, por mbetet problematike transparenca dhe përfshirja e palëve të interesuara, duke sjellë shpesh vendimmarrje të fragmentuar dhe jo të qëndrueshme. Reforma administrativo - territoriale e vitit 2014 vazhdon të ndikojë në arkitekturën e njësive të qeverisjes vendore, ndërsa dixhitalizimi i shërbimeve publike ka qenë zhvillimi më i rëndësishëm i viteve të fundit. Që prej majit 2022, mbi 95% e shërbimeve publike ofrohen online përmes portalit e - Albania, duke reduktuar ndërveprimin fizik në sportelet institucionale. Megjithatë, raportet e vitit 2023 - 2024 tërheqin vëmendjen se ky tranzicion ka krijuar vështirësi për qytetarët e moshës së tretë dhe grupet me aftësi të kufizuara digjitale, duke rritur rrezikun e përjashtimit. Për këtë arsye, konsiderohet e rëndësishme edhe kryerja e auditimeve të performancës në fushën e teknologjisë së informacionit (IT performance audits) për të vlerësuar efektivitetin, aksesueshmërinë dhe sigurinë e shërbimeve online. Në fushën e shërbimit civil, ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, mbetet baza ligjore për zhvillimin e një administrate profesionale dhe të bazuar në meritë.

Departamenti i Administratës Publike (DAP) ka rritur rolin e tij si njësi monitoruese dhe mbështetëse, por sfida kryesore mbetet depolitizimi i administratës dhe forcimi i mekanizmave të rekrutimit transparent. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2024) nënvizon se, ndonëse është arritur një përmirësim në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, politizimi i emërimeve dhe mungesa e reformës në sistemin e pagave mbeten problematika të pazgjidhura.

### **Qëndrimi ose këndvështrimi ndërkombëtar**

Qëndrimi ndërkombëtar mbi administratën publike shqiptare thekson se, vendi ka bërë përparime të dukshme në modernizimin e shërbimeve publike, sidomos përmes dixhitalizimit të tyre në platformën e-Albania, e cila ka mundur ofrimin online të mbi 95% të shërbimeve. Ky zhvillim shihet si një hap i rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit dhe reduktimit të burokracisë, por raportet e BE-së<sup>57</sup> dhe të OECD/SIGMA nënvizojnë se, tranzicioni i menjëhershëm ka krijuar edhe boshllëqe të mëdha, pasi qytetarët e moshës së tretë dhe grupet vulnerabël shpesh nuk kanë mundur të përfitojnë në mënyrë të barabartë. Kjo tregon se dixhitalizimi duhet të shoqërohet me masa mbështetëse për aksesueshmëri dhe përfshirje sociale.<sup>58</sup>

Në aspektin e transparencës dhe politikëbërjes, vlerësimet ndërkombëtare evidentojnë se, procesi i hartimit të ligjeve dhe politikave shpesh shoqërohet me konsultim të pamjaftueshëm publik, gjë që kufizon llogaridhënien dhe rrit perceptimin për mungesë të koherencës dhe qëndrueshmërisë në kohë. Shoqëria civile dhe palët e interesuara shpesh nuk përfshihen në fazat e hershme të vendimmarrjes, çka bie ndesh me standardet e qeverisjes së mirë të promovuara nga BE.<sup>59</sup>

---

<sup>57</sup> Komisioni Evropian – Raporti i Progresit për Shqipërinë 2024, Kapitulli mbi administratën publike dhe qeverisjen [www.enlargement.ec.europa.eu](http://www.enlargement.ec.europa.eu)

<sup>58</sup> OECD/SIGMA – Principles of Public Administration: Monitoring Report Albania (2023).

<sup>59</sup> Për informacione më të detajuara World Bank – Governance Indicators (2023).

Një tjetër problem i theksuar është politizimi i administratës publike. Ligji për nëpunësin civil ka krijuar një bazë të rëndësishme ligjore për profesionalizimin dhe meritokracinë, por raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2024<sup>60</sup> nënvizon se, zbatimi i tij shpesh dëmtohet nga ndikimet politike në rekrutime dhe promovime. Mungesa e reformës në sistemin e pagave, që prej vitit 2006, ka ndikuar negativisht në motivimin dhe mbajtjen e profesionistëve në shërbimin civil.

Në fushën e decentralizimit, vlerësimet ndërkombëtare e pranojnë se reforma administrativo-territoriale e vitit 2014 solli ndryshime strukturore të rëndësishme, por theksojnë se transferimi real i kompetencave dhe burimeve financiare tek njësitë vendore mbetet i pamjaftueshëm. Bashkitë shpesh nuk kanë kapacitetet e nevojshme për të ofruar shërbime efikase, ndërsa varësia nga qeveria qendrore mbetet e lartë.

Së fundi, raportet ndërkombëtare nënvizojnë sfidën e sigurisë kibernetike dhe besueshmërisë së sistemeve publike, sidomos pas sulmeve të vitit 2022, duke theksuar se për Shqipërinë është e domosdoshme forcimi i infrastrukturës TIK dhe garantimi i mbrojtjes së të dhënave personale.<sup>61</sup>

Në përmbledhje, këndvështrimi ndërkombëtar për Shqipërinë është se vendi ka arritur përparime në dixhitalizimin e shërbimeve dhe në ndërtimin e kuadrit ligjor për shërbimin civil, por mbetet ende prapa në transparencë, depolitizim, decentralizim dhe siguri digjitale. Sfida kryesore është transformimi i administratës publike shqiptare në një shërbim efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.<sup>62</sup>

### Auditime të KLSH

KLSH ka kryer një sërë auditimesh në fushën e administratës publike, duke vënë në dukje problematika strukturore dhe menaxheriale që e bëjnë këtë fushë me risk të lartë. Auditimi i vitit 2017 mbi performancën e Departamentit të Administratës Publike (DAP) konstatoi se, sistemi HRMIS, megjithëse i menduar si instrument kyç për menaxhimin e burimeve njerëzore në administratën publike, nuk ishte funksional për shkak të mungesës së një plani strategjik, nivelit të ulët të plotësisimit me të dhëna dhe mungesës së ndërveprimit me sistemet e tjera shtetërore. Në vitin 2018, auditimi i performancës mbi funksionimin e bashkive, në kuadër të Reformës Administrative-Territoriale, tregoi se objektivat e reformës nuk ishin arritur. Legjislacioni nuk zbatohet plotësisht, përthithja e funksioneve dhe burimeve rezultoi e dobët, ndërsa shërbimet për qytetarët mbetën me cilësi të ulët. Auditimi vuri në dukje gjithashtu se, autonomia vendore ishte e kufizuar nga ndërhyrjet e qeverisë qendrore dhe nga financimi i pamjaftueshëm, me buxhet për pushtetin vendor vetëm rreth 1% të PBB-së – niveli më i ulët në rajon.

Po në vitin 2018, KLSH kreu auditimin e performancës me temë “Rritja e kapaciteteve në administratën publike shqiptare, në linjë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm 2030”, me fokus Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe proceset e trajnimit të administratës. U konstatua se ASPA funksiononte pa një rregullore të miratuar, me mungesë të qartë detyrash dhe pa një sistem për matjen e ndikimit të trajnimeve në

---

<sup>60</sup> Shih shënimin në fund të faqes nr. 9.

<sup>61</sup> UN E-Government Survey 2022

<sup>62</sup> Shih OECD 2022 – Open Government Data Report, i cili thekson nevojën për rritjen e aksesit dhe transparencën në të dhënat publike.

performancën e punonjësve. Cilësia e programeve të trajnimit u vlerësua e ulët dhe joefikase, duke mos garantuar zhvillimin e kapaciteteve të qëndrueshme në administratë. Në vitin 2021, KLSH realizoi një auditim tematik të përputhshmërisë tek Departamenti i Administratës Publike, me fokus procesin e ristrukturimit të administratës tatimore qendrore. U konstatuan mangësi serioze në dokumentimin e vendimmarrjes së Komisionit të Ristrukturimit, mungesë transparence, si dhe raste transferimesh të nëpunësve civilë, pa u respektuar plotësisht dispozitat ligjore dhe pa analizuar paraprakisht vakancat ekzistuese. Këto auditime, të kombinuara, tregojnë se performanca e administratës publike shqiptare mbetet një fushë me risk të lartë, për shkak të problemeve me menaxhimin e burimeve njerëzore, depolitizimin, transparencën e vendimmarrjes, funksionalitetin e sistemeve dixhitale (HRMIS), si dhe kapacitetet e kufizuara për trajnimin dhe zhvillimin e nëpunësve civilë. Evidentimi i këtyre problematikave ka shërbyer, jo vetëm për përmirësimin e qeverisjes, por edhe për orientimin e KLSH-së në përcaktimin e prioritetëve të auditimit në të ardhmen, në përputhje me Strategjinë e saj të Zhvillimit (2023–2030).

### Sfidat

Shërbimet e ofruara nga administrata për publikun ende nuk janë të organizuara në mënyrë të plotë dhe eficiente, në mënyrë që të jenë sa më të kuptueshme dhe të aksesueshme për qytetarët. Pavarësisht dixhitalizimit të gjerë përmes platformës e-Albania, qytetarët shpesh hasin vështirësi në përdorim për shkak të ndërfaqes jo gjithmonë miqësore (“user-friendly”), mungesës së asistencës teknike, si dhe problemeve të sigurisë dhe aksesueshmërisë. Tranzicioni i shpejtë nga shërbimet fizike në ato online, i finalizuar në vitin 2022, ka krijuar boshllëqe për qytetarët e moshës së tretë dhe ata me aftësi të kufizuara digjitale, duke shtuar riskun e përjashtimit. Institucionet nuk e kanë të integruar plotësisht në kulturën e tyre organizative synimin për thjeshtimin e proceseve, reduktimin e burokracisë dhe krijimin e një qasjeje të qëndrueshme miqësore ndaj publikut. Për këtë arsye, rekomandohet ndërmarrja e një iniciative të re për rishikimin e proceseve të punës të lidhura me ofrimin e shërbimeve dhe përditësimin e kuadrit ligjor përkatës, duke u mbështetur më shumë në analizën e nevojave reale të qytetarëve dhe bizneseve.

Një sfidë madhore mbetet modernizimi i shërbimeve publike, përmes përdorimit gjithëpërfshirës të teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në të gjitha fushat e administratës. Regjistrat publikë ende nuk janë plotësisht të unifikuar dhe të ndërlidhur, çka e pengon shkëmbimin elektronik të të dhënave midis institucioneve dhe rrit kohën dhe koston e përpunimit të shërbimeve.

Në aspektin e transparencës, institucionet publike shpesh ofrojnë informacion të kufizuar dhe nuk janë plotësisht të hapura ndaj qytetarëve, medias apo shoqërisë civile. Kjo kufizon pjesëmarrjen publike dhe forcon perceptimin e mungesës së llogaridhënies.

Po ashtu, vendimmarrja administrative mbetet e përqendruar në nivelet e larta të institucioneve, duke e ngarkuar panevojshëm drejtuesin me vendime rutinë dhe duke ulur përgjegjshmërinë e niveleve të mesme dhe të ulëta. Synimi strategjik është që përgjegjësia të zhvendoset sa më pranë nivelit funksional ku ushtrohet shërbimi, duke fuqizuar njësitë bazë të administratës dhe agjencitë ekzekutive, si edhe duke rritur kompetencat e tyre në vendimmarrje, buxhetim dhe menaxhim financiar.

## Fushat me risk

Fushat me risk në administratën publike shqiptare, bazuar në të dhënat ndërkombëtare të fundit mund të konsiderohen:

### 1. Depolitizimi dhe profesionalizimi i shërbimit civil

Shërbimi civil vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj ndikimeve politike, sidomos në rekrutime dhe promovime. Pavarësisht ekzistencës së kuadrit ligjor të përshtatshëm (Ligji për nëpunësin civil), zbatimi i tij është i mangët. Sistemi i pagave, i pandryshuar që nga viti 2006, e bën të vështirë tërheqjen dhe mbajtjen e profesionistëve.

### 2. Transparenca dhe llogaridhënia

Politikëbërja dhe procesi legjislativ shpesh mungojnë në transparencë dhe konsultim me palët e interesuara. Raportet ndërkombëtare theksojnë se, administrata mbetet e mbyllur ndaj shoqërisë civile dhe qytetarëve, duke ulur besimin publik dhe duke rritur riskun e korrupsionit.

### 3. Dixhitalizimi dhe siguria kibernetike

Përmes portalit e-Albania, mbi 95% e shërbimeve ofrohen online, por problemi kryesor mbetet siguria e të dhënave dhe besueshmëria e sistemeve. Sulmet kibernetike të vitit 2022 treguan dobësitë serioze të infrastrukturës, ndërsa raportet e BE-së theksojnë nevojën për forcimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e ndërfaqes “user-friendly” për qytetarët, veçanërisht për grupet vulnerabël.

### 4. Decentralizimi dhe qeverisja vendore

Reforma administrativo-territoriale e vitit 2014 nuk ka sjellë akoma fuqizimin real të pushtetit vendor. Njësitë e qeverisjes vendore mbeten të varura financiarisht nga qeveria qendrore dhe kanë kapacitete të kufizuara për të ofruar shërbime cilësore. Buxheti për pushtetin vendor është ende ndër më të ulët në rajon si përqindje e PBB-së.

### 5. Kapacitetet administrative dhe zhvillimi i burimeve njerëzore

Kapacitetet institucionale për hartimin dhe zbatimin e politikave mbeten të dobëta. Trajnimet nuk janë gjithmonë të lidhura me nevojat reale të administratës dhe mungon një sistem gjithëpërfshirës për matjen e ndikimit të tyre. Kjo dëmton efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike.